

MBRESA NGA NJË GRUP VIZITORËSH NË SHËN MARENË TË MOKRËS

# Një doli vere në Shën Marenë

**Një zë nga Pogradeci  
i përhershëm**

Bisedë me shkrimtarin Ardian-  
Christian Kyçyku - Pogradec-  
Bukuresht, gusht 2009



**MBLIDHEN BILBILËNJTË  
NË "TRADI-BAR MOKRA"**  
Nga Nesti Maçolli

**Drejtori që  
vlerësonte punën e  
jo biografitë**  
Nga Pellumb ZADE

**17-25 KORRIK 1975,  
EKSPEDITË KOREOGRAFIKE  
NË ZONËN E MOKRËS**  
**Vallet e burrave**  
Nga prof.  
Ramazan BOGDANI



**JETON JETËN ME  
DINJITET, ME  
KRIJIMTARI ARTISTIKE**  
Nga Zenun FERO

Nga Koço PIHONI

**M**e doktor Jani Bashën, Profesor Sazan Çeliku, Ismail Xhaja, Istref Haxhillari, Vasfi Sherri, e tjerë më 18 korrik 2009 vizituan Shën Marenën në Llëngë.

Nisja u bë nga dalja e qyteti të Pogradecit e vazhdoi rrugën nëpër fshatin Vërdovë, në Varret e Grekut, emër që mbahet nga të varrosurit, të rënë në luftën e Dytë Italo - Greke.

Aritëm në Podgozhan, ku makina u ndal për të marrë përhëndetjet nga zoti Miallaq Burnazi me një kulaç. Kur pa e njohu dr. Jovan Bashon. Si na dha të gjithëve dorën i tha atij veç të tjerash: "Doktor, ti je i yni!" dhe doktori e pohoi duke iu përgjigjur: "Po të gjithë tanët jemi!"

Makina vazhdoi rrugën, duke lënë në të sipërm, Malinën e Trebinjën. drejt Çezmave, Hondishtit dhe dolëm së fundi në Mujazë. Ndali kur aritëm lart te kryqi. Gjatë rrugës, patëm mundësinë të bisedonim e të mësonim nga doktori pasionin në rini për sportin e skive. Kish qenë shpesh në ato dimra me disa shokë të atyre viteve në livadhet e Podgozhanit. Mësuam për pasionin e tij për filatelinë dhe se vazhdonte të ishte një koleksionist i vjetër e serioz. Trashëgonte një koleksion të pasur e të rrallë pullash postare nga i ati, i paharruari Kozma Basho. Nga rezervuarët e Mujazës dukej fshati, dikur qyteza, e Llëngës, tashmë gati e braktisur. Na bëri përshtypje se po shfaqen shpresa për ta rigjallëruar, se banorët e pakët kishin ngritur një kishë të re, kishën e Shën Gjergjit, ndërtuar me kontributin e fshatarëve, të shpërngulurve e me mbështetjen financiare edhe të Ambasadës Rumune në Tiranë. Mësuam se z. ambasadur kish qënë me origjinë nga ky fshat, nga fisi i Pihonave, dhe ishte shprehur se do jetë i pranishëm në Llëngë e Shën Marenë gjatë këtij sezoni veror.

Dr. Bashua vlerësoi atë punë të mirë dhe u shpreh se me të drejtë ka ndihmuar ambasada Rumune, se besimi fetar në këto anët tona i të krishterëve orthodhoksë e ka rrënjën nga qyteti dhe kultura 2400 vjecare dhe kisha e Patriarkana e qytetit të lashtë të Beratit, më ata kodikët e shenjtë të rrallë në botë, prej nga vareshin kishat e manastiret e kësaj treve përfshi Ohrin, Voskopojën, Vithkuqin (jo nga kisha e Partiarkana Greke). Kjo është dhe arsyeja që nuk investohet e restaurohet kjo pasuri e kulturës tonë kombëtare. Ndërsa gjatë gjithë kësaj kohe prof. Sazan Çeliku jepte dhe merrte me Ismailin për ato qindra e mijëra lloje e soje luluri bimësh medicinale që ne parakalonim.

"Besoj se nuk do jenë të njohura as edhe nëpër sistematikat e bimëve", kësh-tu që profesori i hap punë vetes edhe në kthim. Do t'i duhej të plotësojë kushedi sa bimë të munguara në sistematikën e Karl Lineut. Mbërritja u bë shëndoshë e mirë në destinacion, por tani na prisnin detyra të tjera për të plotësuar dhe përmbushur tamam shartet e këtij udhëtimi. Detyrat ishin: therja e mishit të kurbanit, marrë i gjallë me këmbët e tij, pjekja e tij për shtatë palë qejfe, më pas ndarja, denetisja sipas vendit e nderit dhe së fundi këndimi i shpatullës së kurbanit nga "orakulli", në prani të shokëve e pjestarëve.

hilleri, Koço Pihoni e Vasfi Sheri. Ndërkohë, qilarxhiu urdhëron ndihmësin e tij, "dajon" e fëmijëve të Xhajës, të sjellë shishe me pije raki, verë, birra e pije freskuese, të cilave iu shtuan dhe dy shishe verë e sjellë nga Italia në Tiranë e prej andej në Shën Marenë nga dr. Bashua. U mbushën gotat dhe u urua mirëseardhja e u dha leja e pirjes të disa gotave të tjera sipas dëshirës. Ndërkohë, me porosi të qilarxhiut, mbërriti si për "këmbë e parë", zoti "Kulaç i Mokrës". Gjatë kohës po vinin kurbanit, mishi i pjekur dhe një tavë me peshk, koran lumi. Pastaj erdhën bostanoret dhe disa mëshere djathi që e shoqëruan dhe e plotësuan atë dreqë a gosti. Në këtë sebeb fjala e "çeljes" iu dha zotit "kulaç".



Një grup turistësh nëpër Mokër (foto arkiv)

Pak veta e kanë dhunti këtë marifetin e njohjes së shpatullës.

Pasi u qetësuan, shkuan në kishë ndezën qirin e u lutën e falën me besim në një Zot. Doktori me fëmijët shkuan poshtë, te Shpella, vend strehimi i shënjtore Shën Marena, ku morën copa guri dhe bënë fotografi. Më pas vizituan varrin lapidar të papa Kostandin Pihonit këtij kleriku patriot, komandant e bashkëpun-tor kryesor për çështjen kombëtare, nga Lidhja e Prizrenit, shkollat e para shqipe, në ngritjen e flamurit dhe deri në Kongresin e Lushnjës.

Më pas doktori me fëmijët e tij shkuan dhe u freskuan në vendburimin ujqor të bekuar, të Najzazmës. Profesor Sazani tregoi interes dhe për dicka tjetër. Shkoi vizitoi dhe konakët, dikur Karvan Sarajet e manastirit. Më pas ai ish spital partizan e vend qëndrimi i misionit anglez, i cili është lënë në gjëndje të mjerushme.

Më pas, në shoqërinë e Istref Haxhillarit e Ismail Xhajës pimë nga një kafe e nga një gotë raki te lokali i Manastirit. Aty u pritëm e na u urua mirëseardhja nga kujdestari i Manastirit, Nasi Tona, në mungesë të priftit, papu Degërmenit nga Pleshishti i trimave të Mokrës, që nga bashkëlufëtaret e Skënderbeut. Angjelini, pastaj Naum Shyta (mik i besës i Ali Pashës), Gjokë Shqiptari, e shumë atdhetarë edhe të luftës Nacional Çlirimtare. Më pas shkuan për të drekuar. Si zumë vendet të gjithë pjesmarrësit, të shtruar këmbë kryq në lëndinë, zonjave të nderuara dhe fëmijëve të tyre u sugjerua të zinin vend më afër vendndodhjes së kishës së Shën Marenës dhe më pas vinin të tjerët. Me vendin e "mikut të parë" u nderua prof. Sazani. Përkrah vinte dr. Jani dhe nga "të zotët e shtëpisë" ishin Ismail Xhaja, Istref Hax-

hillari, Koço Pihoni e Vasfi Sheri. Ndërkohë, qilarxhiu urdhëron ndihmësin e tij, "dajon" e fëmijëve të Xhajës, të sjellë shishe me pije raki, verë, birra e pije freskuese, të cilave iu shtuan dhe dy shishe verë e sjellë nga Italia në Tiranë e prej andej në Shën Marenë nga dr. Bashua. U mbushën gotat dhe u urua mirëseardhja e u dha leja e pirjes të disa gotave të tjera sipas dëshirës. Ndërkohë, me porosi të qilarxhiut, mbërriti si për "këmbë e parë", zoti "Kulaç i Mokrës". Gjatë kohës po vinin kurbanit, mishi i pjekur dhe një tavë me peshk, koran lumi. Pastaj erdhën bostanoret dhe disa mëshere djathi që e shoqëruan dhe e plotësuan atë dreqë a gosti. Në këtë sebeb fjala e "çeljes" iu dha zotit "kulaç".

Më pas, radha i erdhi dollisë, asaj kushtetute të mokrarëve, që pak popuj në botë e njohin dhe e nderojnë. Po të njëjhej dhe zbatohet në veri, shumë gjaqe do gjenin zgjidhje. Mbas urimit nga të zotët e shtëpisë, dollinë e mikut e bëri profesori Sazani. Për ta ndihmuar, me detyrën e sekretarit u ngarkua zoti Istref. Dollia shkoi mirë. E rëndësishme ishte dhe ndarja e mishit. "Nishanet" u vendosën duke respektuar së pari ato zonjat e nderuara. Këtu bëhej fjalë për kokën, shpatullën, pjesën e bishit. U nderuan zonjat, i ka demokracia këto! Këngë të vjetra poradecare, shumë rrallë të dëgjua, të kënduara veçmas nga dr. Bashua në shoqërinë e të tjerëve.

Le t'i lutemi Zotit të na japë forcë e shëndet dhe viti 2010 të na gjejë më të ditur e më të pasur e më pjellorë nga mendja.

Llëngë 28 korrik 2009

Falenderojmë z. Dhori Spirollari për sponsorizimin e pjesshëm të këtij numri

# MBLIDHEN BILBILLENJTË NË "TRADI-BAR MOKRA"

Nga Nesti MAÇOLLI

**K**ënga, më ushqente shpirtin, ka thënë një mokrar i motshëm, që u tret nga malli për Mokër e Shqipëri, përtej oqeanit. Si e tillë, kënga mban brenda vetes melodinë, gërshetuar me finesë me vargjet që më së shumti janë tharmi, që depërton në shpirtin e njeriut. Ajo lind e rritet në shtratin e një individi, familje, grupimi shoqëror, në fshat, krahinë e qytet; që mbart predispozita gjinore të trashëguara brez pas brezi. Mokra, e ka pjesë të jetës këngën popullore folklorike.

Në Mokër, vështirë se gjen një familje që së paku, një anëtar i saj të mos dijë të këndojë; më së shumti të mbeshtet me iso sapo ti t'ia marrësh këngës. Pa dyshim, zërat e bukur, interpretuesit virtuozë që e "qajnë" këngën folk janë bilbila kafazi. Këta nuk mund t'i gjejmë me lehtësi në thellësi të dhjetë dekadave. T'i qemtosh e t'i rrokësh ata është e vështirë, por kënga që rrjedh si ujërat e Gurit të Kamjes, Kozicit, shpellës së Shën Marenës dhe Hallmit vjen deri në ditët tona plot emociion e hijeshi.

Falë mjeshtrit të letrave Mitrush Kuteli, si mbledhës i parë i këngëve popullore të Pogradecit, në librin e tij "Këngë e britma nga qyteti i djegur" shprehet:

- Kënga... në qoftë se përmban brenda saj ndonjë thërime arti të vërtetë, shkon gojë më gojë me krahët e erës. Këngët i sjell era.

Mbledhës të folklorit mokrar me botime të posaçme janë edhe librat e "Këngë nga rrethi i Pogradecit" i Tomor Starovës dhe "Këngë folklorike nga rrethi i Pogradecit" i Gjergji T. Gushos. Për këdo, që kërkon të njohë dhe mësojë këngën në vargje, këta mbledhës janë burimi dhe vlera e qytetit tonë.

Kënga folklorike mokrare, e ndarë sipas kriterit gjinoro-tematik, përcjell mesazhe njerëzore që ia bëjnë më të bukur e më të lehtë jetën njeriut. E lartëson atë për frymëmarrje të kthjellta... Mes këngëve je si mes ëngjëjve. Paçka ndarjeve në këngë epiko-lirike (balada), epiko-historike, liriko-familjare, lirike-shoqërore sikundër i paraqet mbledhësi Gjergji T. Gusho, ato së bashku përbëjnë shportën me lulet më të bukura që sjell Pranvera në Mokër.

Duke ndier se nuk e kam të lehtë qemtimit, për zgjedhjen dhe thithjen e nektarit në kaq e kaq këngë, po marr përsipër të zhbiroj sadopak këtë shportë mokrare me këngë dhe bilbila, ashtu siç ma do zemra për ta shpërndarë aromën e tyre gjithandej në Shqipëri dhe përtej kufijve tokësorë e ujorë.

Ja sa bukur e me elegancë këndohet kjo këngë në Potgozhan:

*Gusha jote e bardhë shtatë a tetë radhë  
Buza jote e kuqe të pikoka mjaltë  
Ti qënke kokone, s'qënke për t'u sharë  
Ta marrshin të kegen, t'u bëfshin kurban.*

Si kundër thamë, kënga në Mokër vjen nga thellësitë e viteve mbuluar me pahë pluhuri, por sapo zë t'a fshish "pluhurin" do të magjepsesh nga vezullimi, do zbulosh portrete me zëra brilantë. Thonë që Xhamio i Postolit në Potgozhan ka qënë një gur xhevahiri në këngë. Edhe në fiset e Vakollarëve, Bitrove, Burnazëve është kënduar bukur si nga burrat dhe nga gratë. Pinjolli i fisit të Hilave, Llambi Hila, është një zë i veçantë dhe impulsiv që krenohet si mokrar i vërtetë.

Këngët e nizamat dhe të kurbetit interpretoheshin me dihatjen e shpirtit që pret e vuan. Një visar është edhe kjo këngë që këndohet në Potgozhan:

*Rabistan, i shkreti viran  
Bëre nusen që të qajë...*

*T'i dërgojmë djalit të vijë  
Në mos ardhë dhe tani  
Merre urën e digj shtëpinë  
Ta bëjmë shesh, ta bëjmë lëndinë*

Në Mokër, kanë kënduar e këndojnë në perfeksion këngën popullore dhjetëra Athina, Marina, Dhorka, Xhevriko, Bylyre dhe Selime. Të gjitha kanë ndezur dasma e gëzime.

Ashtu si thotë Kuteli: "Këngët i sjell era", edhe mua era e këngës më hedh rrjedhës së Shkumbinit dhe më ngjit shullërit për Laktesh; një ndër fshatrat e Mokrës së Poshtme, me vlera të spikatura të karakterit mokrar. Fshati Laktesh, ndër vite, ka një vatër bujare me elemente të humorit të hollë dhe impulsivitet të këngës dhe muhabetit në sofër. Sigurisht është e vështirë të veçosh individë, kur ata janë njëri gur më i rëndë se tjetri në llojshmërinë e këngës dhe interpretimit. Po përmend Nazif Manin, i cili këndonte bukur, por respektonte dhe vlerësonte këngën e mikut që muhabeti pranë oxhakut ku digjej ngadalë zgërbonja e dushkut të shkonte si nusja në kalë, siç thoshte vetë Nazifi. Një zë i veçantë ishte edhe i nipi i Nazif Manit, Ethem Hadri nga Rrodokali Sipër, i cili vlerat e këngës i ka çuar në festivalet e Gjirokastrës, ku është lauruar me çmime. Në Laktesh, këndohej dhe këndohet ende në fis të Belegëve, Gjonave etj.

A e shihni që duke fshirë pahën e pluhurit në vite; sadopak po risjellim në kujtesën e mokrarëve, ata njerëz me cilësi fisnike dhe dhunti gjinore në këngë.


Ngjitemi pak më tej të kapim Velçanin, nga ku fërfërin era e korijes dhe na sjell në mend dhjetra këngë të vjetra e të reja, të latuara me lezet nga zëri i mjeshtrave të tyre dhe i djaloshtit të talentuar të Velçanit Avni Lushka. Ja një copëz nga këngët e shumta të fshatit Velçan:

*Në krye të fshatit ma kishe shtëpinë  
Në syçkën e zezë brënda një shkëndijë  
Në të marrtë malli dërgo e më thirrë*

Plot burra e djem kanë kënduar me bukuri e pasion në Velçan. Me respekt përmendim 80 vjeçarim Mislum Lufo, që me këngën dhe vallen e tij ka ndezur skenat e festivaleve. Lyfti Mysliu, Kadri Velo e të tjerë burra ndër vite, janë identifikuar me këngën në gostira e dasma. Këta individë i sjell në kujtesë gjinekologu, djali i Velçanit, Nexhmi Elezi tek pinim së bashku një kafe tek "Tradi-Bar Mokra".

Ç'është kështu me këngën dhe vallen?! Mbushesh me emociion dhe dialogon me veten... Pse jo; Nga pena që shkruan rrjedhin hoje mjalti që veçse me veshë mund t'i shijosh.

Kriçkova, përbri "Pelionit", gjithmonë ka qënë një gur xhevahiri në këngë. Me dy çifte të përsosura të vëllazërisë Bufi, Qemal dhe Hamdi, Muharrem dhe Arefi Bufi, teksa kanë zbuluar skenën e festivaleve, kanë sjellë romantikën dhe brishtësinë e këngëve që buron nga shpirti i gjerë dhe fisnik i tyre. Pikërisht me këngët "Bilbil të zu dëborë" dhe "O Çoban të dua shumë" janë skalitur në kujtesën e mokrarëve dhe më gjerë në Bërzesh të Valamarë. Në këto dy familje më ka ndodhur të jem mik shtëpi. Në shtëpinë e Qemal Bufit dhe Muharrem Bufit, buzagaz të presin nga foshnja i djepit, zonja e shtëpisë deri tek më plaku me mustaqe të varura rëndë rëndë. Qemali e ka percjellë këngën dhe tek fëmijët e tij vajzat e djemtë. Djali i madh Edmondi, në moshën 13 vjeçare fitoi çmimin e parë në festivalin e këngës popullore në Pogradec, me pjesëmarrje të gjerë nga qarku ynë. A s'kanë të drejtë mokrarët të krenohen me këta bilbiljenj të vjetër e të rinj? Po me Dilaver Begon e Slabinjës që nuk iu nda këngës e punës derisa u nda



Nesti MAÇOLLI

nga jeta? As janë nota në pentagram këta zëra që nuk studiuin Konservatorë e shkolla arti por që përbëjnë gjerdanin e këngës mokrare si: Maliq Hamzallari (Kalivaç), Ferit Xhika (Hondisht), Jovan Maçolli, Llambi Kumbulla (Pleshisht), Nuni Hila, Misto Kollçaku, Stefan Tola (Potgozhan), Ilmi Ademaj (Selce e Sipërme)? Po vajzat virtuozë nga fshati Llëngë, Marjeta Divjaka dhe Vjollca Dhimitri që me këngët: "Shtiva sytë moj nënë" dhe "Kapedan Shahin Matrakut" kanë tundur skenën e festivalit në Gjirokastrë në vitin 1983? Po zëri rrëqethës i Adriana Doces nga Pleshisht, a s'është një notë pentagrami, që me këngën "Preva një fustan 40 kutë gallate", emociion dhe drithëron publikun në kalanë e Gjirokastrës?

Me trilën dhe vibraton e bukur spikat dhe këngëtari nga Llënga, Petraç Gjoka, i cili është përfaqësuar me grupin e rumunëve deri në Rumani.

Vite më parë, kur kam qënë mësues në Selcën e Poshtme, më ka ndodhur që në dasmat e familjarëve Xhezar Oparaku dhe Gani Xhyra të më lërë mbresa zëri i mjekut të ndërë Shefki Oparaku dhe i djaloshtit me flokët bjond nga fisi Kapri të fshatit Golik. Ky i fundit, më kujtonte majën e këngës mokrare, brilantin Faik Kastrioti.

Le të qëndrojmë këtu. Pikërisht, në fshatin Çezmë të Faik Kastriotit. Çezmerët, burra të fisshëm, mjaltë të këngës, trima të pushkës dhe besës. Megjithëse Mokra jonë e dashur e rrudhur prej mallit, e zhveshur prej ikjes... në familjet që ende jetojnë e punojnë në shtratin e të parëve, glon kënga dhe vallja. Faik Kastrioti u prin pinjollëve të Çezmës dhe mbarë Mokrës. Ai mbetet maja e aureolës. Pas e ndjekin Vait e Nazmi Kastrioti. Së bashku kanë begatuar festivale të shumtë në mbarë vendin. Siç e dini, vëllezër mokrarë, përballë Çezmës së Madhe dhe të Vogël, përmatanë lumit, dikur Çordol e Vemiranë, sot janë Pleshisht, Trebinja dhe Pevelani.

Im At Thanas Maçolli, ndër dhjetra bëma, për këngën i qante shpirti... Ai tregonte se kur këndonin çezmëret për matanë lumit, në Pleshisht dridhej penxherja... Edhe kur ia merrte yt gjysh Spiro dhe ia mbante këngën xha Vani, me drejtohej mua, në Çezmë rrëshkiste dheri tatëpjetë... Brahim Baçi hapte penxheret... Nusët linin djepet, palaretë...

Në brezat e mëvonë, Pleshishti e ngjizi këngën tek nipër e mbesa. Xha Vasili (Meko) thoshte: Mbrëmë m'u zbardh konaku nga kënga e mikut. Kur këndonin djemtë e çupat e Pleshishtit dridhte mustaqen e fisnikërohej. Dasmat në Pleshisht buçasin nga këngët. Të rinjtë, me shumë dëshirë këndojnë këngët e bukura të Miti, Pasko e Jovan Spirollarit, Llambi e Vasil Degërmenit, Vangjel Maçollit etj, këngët e të cilëve janë të vjetra dhe me kajmak si ato fasulet zjere ngadalë mbi prush në poçen e baltës. Në fis të Maçollëve, brez pas brezi, kënga ka qënë lajtmotiv i jetës. Thanas Maçolli, burri që nuk përcolli mikun asnjëherë pa këngë, si në Pleshisht ashtu edhe në Pogradec, i thoshte gruas së tij Maries:

-Qepë e pak gjizë grua, në mos këndezin e vetëm, se mezen e mezesë e kemi vetë.

E kishte fjalën për këngën. Në dhjetra këngë të tij po kujtoj:

*Behari po vjen dimri po na shkon  
Plagët e mia kush po mi shëron...*

Kjo këngë brilante në zënë e dridhur të Thanasit të ngjethte trupin pse jo edhe lot në sy të rridhnin. Atij i qeshte fytyra kur këndonte këngën:

*Të mori bandilli në pelën baluke  
Tarinani-nani hajde moj Manushe  
Hajde Hajde ti moj marshallah*

Mjaft bukur në Pleshisht kanë kënduar në fisin Pjetri. Tasi Pjetri, në djalërinë e tij të hershme, me portretin ekspresiv, flokët e gjata si të Çerçizit, tek punonte në arë ia merrte me fyell këngës ashtu në të qarë... dhe zogjtë mbanin vesh tregonte motra e tij Marie. Ia kështu këndojnë pleshishtëret... Edhe ne pinjollët e tyre e duam dhe e këndojmë këngën. E si të mos thuash dy fjalë për vëlla e motër Virxhil Maçolli e Ervelina Kycyku (Maçolli), që me zërin e spikatur dhe interpretimin e ngrohtë kanë lënë gjurmë jete në festivale folklorike kombëtare, në Gjirokastrë e Berat e në plot festa lokale. Këngët e tyre, "Një pikë në dorë, një nishan në ballë" dhe "Gjok Pjetër Shqiptarit" janë borzilok i çelur në shkëmb. Aroma e tyre, edhe sot, prek telat e shpirtit.

Siç e shihni, kurora e shportës me buqetën e këngëve do e mbyllë "Harkun e Triumfit" me zërat e djemve të Trebinjës dhe Dunicës. Djaloshi simpatik Tomorr Muço, të rrëmben me këngën e tij, të bën për vete. Fari Muço, autor i mjaft këngëve në Mokër, e ka parë suksesin në disa festivale dhe tribunarë folklorikë.

Çudi me mokrarët, janë si lisat që mbajnë kryet lart, duan të kapin qiejt... Hije rëndë dhe levendë. Tundin dhenë... Ja kështu është Tarja me Safetin, bilbiljenj që fuqinë e këngës e marrin nga dheu, e përçojnë enëve të gjakut dhe ndezin qiellin. Në Dunicë, Kalivaç, Malinë e Trebinjë kënga vjen rrotull... e shin vranë dhe sjell buzëqeshjen korije më korije, shtëpi më shtëpi. Le të ndalemi tek Safeti dhe Tarja, burra të hijshëm, u ka lezet takija mbi kokë, brezi dhe fustanella. Në fondin e gjerë të folkut mokrar, burrat e Dunicës kanë skalitur një nga perlat e këngës folklorike mbarëshqiptare si:

*Ti moj kulla me tre kate  
Ç'e bëre Jaçen që pate*

As janë për t'u hequr kapelen këta bilbiljenj mokrarë?! Gjithkund në Mokër këndojnë bukur, Malinë e Kalivaç, Pevelanë e Hondisht, Losnikë e Vërrri, Slatinë e Homezh, Homçan, Selcë Poshtë e Selcë Lart, Zëmçë e Somotinë, Hoshtecë e Jollë. Kudo një bilbil të pret me këngë në gojë. Veç ec... ec... shtruar gjen një sofër, hapur pret një portë.

E ç'mu desh mua pinjollit të këngës mokrare t'i hyja kësaj valle?! Ishte valle e rëndë... Gjithsesi më jepni pak krahë në kam mundur t'u sjell copëza malli, respekti, dhe krenarie me këto xhevahire folklorike, që së bashku përbëjnë shportën e bukur të mokrarit.

# Një zë nga Pogradeci i përhershëm

Bisedë me shkrimtarin Ardian-Christian Kçyçku - Pogradec-Bukuresht, gusht 2009

**Llazi Tona:** E keqja tek ne sh qiptarët është se nuk njohim trun gun tonë familjar, të paktën deri në 7 breza para nesh. Cilët janë gjyshërit dhe stërgjyshërit tuaj, çfarë kanë bërë ata për fisin tuaj, për kombin, ku janë shquar... E them këtë, sepse pikërisht të parët na sollën në ditët e sotme dhe sepse, nga mosnjohja, kanë lindur mjaft shfaqje të këqija. Mendimi juaj?

**Ardian-Christian Kçyçku:** E keqja nuk është se shumica nuk e njohin prejardhjen, por se, duke e njohur, apo pa e njohur veçse përciptazi, nisin e sajojnë, e mbushin me lajlelule, e fisnikërojnë dhe presin të drithëruar që dëshmitarët e së vërtetës të vdesin pa e hapur gojën, ose të mos i besojë kush. Këto të këqija nuk më janë avitur, sepse i njoh mjaft mirë rrënjët. Njëri prej katragjyshërve të mi, Thanas Kçyçku, për shembull, di se tregtonte gurë (themelesh, ose muresh) deri në Vjenë, Budapest, Selanik, Bukuresht, Stamboll e gjetkë. Ndoshta qenë copëra nga shkëmbinjë anës gjolit. Duket si një mënyrë për të shpërndarë nga pak histori, kujtesë dhe shije të epërme Poradeci nëpër Evropë. Njëri nga djemtë e tij, Stefan Kçyçku, u zgjodh kryeplak në zonën tonë, me myhyr të posaçëm nga Porta e Lartë. Aleksandër Kçyçku, djali i tij i madh, zgjeroi e pasuroi më tej Hanin e Kçyçkëve, që përmendet edhe në ditaret e disa udhëtarëve perëndimorë, pastaj mërgoi në Amerikë, ku i ka eshtrat edhe sot e kësaj dite. Stërgjyshi tjetër, Leon Kristo Ilo, ishte tregtar që u kthye në Pogradec pasi punoi plot 26 vjet në Stamboll, ku pati, mes të tjerash, edhe dy hotele në lagjen Beyoglu, që njihej e vazhdon të njihet si lagja më moderne e Konstandinopojës. Gjyshërit e mi, Llazi Kçyçku dhe Vangjel Koci (nga ana e nënës) ishin të dy mjeshtër në përpunimin e drurit, mobiljerë, njerëz të thjeshtë, me zanatin mësuar në Ohër, rrëfimtari të rrallë, secili me një stil e ritëm të dalueshëm nga tjetri, njëri më i rrënjësor në mitologji, tjetri në historinë e përditshme. Gjyshërit mbetën për mua dy shkrimtarët më të shquar të shqipërisë, ndonëse nuk botuan asnjë rresht.

**- Ç'dini ju për trungun e Kçyçkëve? Vendi dhe datëlindja juaj?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Pjesë nga saga e jashtëzakonshme e Kçyçkëve, fisi nga i cili rrjedh, i kam shkruar në disa prej librave të mi, që shoqërohen me fjalën "shkujtime", ngaqë janë kujtime të një lloji të veçantë. Nga Kçyçkët kanë dalë njerëz me shkëlqim të fshehur, ta themi, si Koli Kçyçku, kryeplak, nëna e Lasgushit, Kostandina, apo nëna e poetit të sotëm Dhimitër Pojanaku. Do të përmend me nderim edhe të ndjerin Gjorgji Kçyçku, hxahxhin e tim eti, emrin e të cilit e mban tani stadiumi i Pogradecit. Disa nga dhuntitë e moçme të fisit janë ruajtur ende, në kushtet e tanishme... Mirpo ashtu siç ka libra, të cilët nuk mund t'i lexosh e t'i tretësh pa kaluar një moshë, ose një shkallë të caktuar drite, paska edhe libra, të cilët s'mund ta shohin dritën e botimit atëhere kur dëshiron autori. Sepse vërtet kam dashur që gjyshërit e mi të mund të më lexojnë. Nuk qe e thënë. Prandaj vazhdoj të pres atë çast botimi dhe të pi nga një cigare me varret e tyre, kur vij këtu.

Jam lindur në Pogradec më 23 gusht 1969. Dyzet vjet më vonë, pra, para pak ditësh, kalova bashkë me tim atë para maternitetit të vjetër dhe i bëra ngrehinës një fotografi. Dyzet vjet më parë fotografoja qytetin nga materniteti, i thashë, kurse tani



Ardian-Christian Kçyçku

maternitetin nga qyteti.

**- Prindërit tuaj. Jeta dhe veprimtaria e tyre në shoqërinë shqiptare...**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Në fillim të viteve '90, ndodhi të takoja një nënë që thoshte si e dalë mendsh: Of, shyqyr që na ikën çunat jashtë, që të rrojmë edhe ne ca më mirë! Prindërit e mi erdhën pas meje dhe tim vëllai në Bukuresht dhe jo vetëm ndanë me ne hidhërimet e gëzimet, por edhe na mbajtën me bukë, me shtëpi e me zemër, ashtu siç rrallë di të ketë ndodhur. Për tim atë, Kopi Kçyçkun, flasin më mirë ata mbi 50 libra që ka shkruar e botuar, në fusha si letërsia, historia, publicistika, memorialistika e gjeologjia, apo puna që ka bërë që nga miniera e Gurit të Kuq, Ndërmarrja Gjeologjike, Komiteti Ekzekutiv, Kuvendi i Shqipërisë, Televizioni Shqiptar, Ministria e Punëve të Jashtme, Universiteti i Tiranës, Akademia e Shkencave, Universiteti i Bukureshtit etj. Nëna, Martha Kçyçku, ka qënë mësuese, që nga Starova e viteve '60 në Babrrunë dhe Tiranën e viteve '80, dhe, veç ndihmës së pazëvendësueshme në rritjen e sime bije, ka gatuar që unë të mund të shkruaj shqip duke u ushqyer shqip.

**- Ç'është për ju femëria?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Parajsa për të cilën as vetë nuk di si t'i shtrosh pyetjet. Më saktë: përgjigjja vendimtare e vegimtare që të dhurohet nga Lart, kur ende nuk di ç'domethënë pyetje.

**- Çfarë shkollimi keni kryer?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Pas kopshtit "Tomka Laçka", ndërtesa e të cilit ishte një çudi më vete, nisa shkollën "Gjok Shqiptari". Pastaj u shpërngulëm në Tiranë, ku përfundova filloren tek "Hoxha Tahsini" dhe të mesmen "Partizani". Këra Fakultetit e Histori-Filologjisë në Tiranë, dega Gjuhë-Letërsi, dhe doktoraturën e parë, në letërsi botërore e të krahasuar, në Universitetin e Bukureshtit. Njëkohësisht, ndoqa stu-

**Ardian-Christian Kçyçku:** Koha kur, në mungesë të letërsisë, nuk të vjen të besosh se një ditë do të merresh nga kjo botë.

**- Keni botuar libra. Cilët janë ata dhe a mund të na i përshkruani me pak fjalë?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Është e panatyrshme të bëj një përshkrim të tillë. Po rendis vetëm titujt e tyre, ashtu siç gjenden në Curriculum Vitae, duke u kërkuar ndjesë librave ende të pabotuar, që, në disa raste, janë më të rëndësishëm për mua, se sa të botuarit. Vepra letrare të shkruara e të botuara në gjuhën shqipe: *Triumfi i Proteut*, roman, 1990 (samizdat), *Në perandorinë e gurit*, roman, 1993, *Mortët*, roman, 1994 (samizdat), 1997, *Nata pas vitit zero*, novela, 1998, *Përkthimi ose Jeta e një robi që nuk betohej se shihte*, roman, 1999, *Muza e Lojës*, tre romane, 1999, *Lumenjtë e Saharasë*, roman, 1999, 2009, *Oreksi për bukën e qiellit*, roman, 2000, *Diva ose Ngrënësi i Luleve*, roman, 2001, *Engjëjt e tepërt*, roman, 2002, 2009, *Kristali dhe hienat*, roman, 2002, *Sy*, roman, 2004, 2006, 2007, *Si u pushtua Çmendustani*, roman, 2004, *Home*, roman, 2007, *Në vend të Përtjetësisë*, dramë, 2007, *Puthmë skelet - roman me femini*, 2008, *Zv.Libri, copëza jete a letre frymnëzuar nga teatri*, dramë, 2008, *Gjaku asnjans - jetë suflerësh*, dramë, 2009, *Ati, rrëfim*, 2009

Vepra letrare të shkruara e të botuara në gjuhën rumune: *Viti kur u shpik mjellma*, roman, 1997, 2002, *E fshehta e ëmbël e marrëzisë*, roman, 1998, 2002, *Një fis i lavdishëm e që jep shpirt - epopeja e një harrese*, 1998, 2002, 2005, *Hyu Epigon*, roman-ese, mbi jetën dhe veprën e poetit Lasgush Poradeci, 2000, *Dashuri me shikim të fundit*, prozë dhe teatër, 2000, *Trilogjia*, prozë e zgjedhur, 2002, *Koha e zëvendësve*, libër-intervistë kushtuar shpirtëritimit shqiptar, 2003, *Shtetrrrethim - roman i shkruar me shumë pak thonjëza*, 2004, 2008, *Ish - roman me dashuri & konspiracion*, 2005, *Një alfabet i poezisë shqipe*, antologji, 101 poetë shqiptarë në gjuhën rumune, 2003, *Hyrje në semiotikë*, ligjërrata universitare, 2004, *Shenjat dhe Kështjella*, ligjërrata universitare, 2006

*Ligjërimi i një pagjumësie* (Brevetarea unei insomni) - studim kushtuar jetës dhe veprës së 8 autorëve shqiptarë që u përfshinë në vëllimin I të antologjisë "Bukuria që vret", zgjedhur e përkthyer nga Kopi Kçyçku, Bukuresht 2006, *Vend për një kukull të vetme - rrëfim për t'u filmuar / film për t'u rrëfyer*, 2008, *Empatikoni ose Libri i jetës së parakohëshme*, roman 2009

**- Me çfarë kulture jeni pajisur: të Evropës Lindore, apo Perëndimore?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Kultura mund të jetë shpirtërore, ose jo, prirur ndaj Frymës, ose ndaj lëndës. Besoj se, së shpejti, zonat e sunduara tashmë nga lënda, zvjerdhur e trembur nga mefshtësia e kumtit kulturor që përcjellin dhe e së ardhmes, do të nguten t'u venë hapësirave dhe ngjarjeve emrat e vërtetë, duke e ndarë si duhet shapin nga sheqeri.

**- Hegeli ka ndaj letërsisë dhe arteve pikë-pamjen se fantazia ndaj realitetit është si krimbi ndaj elefantit. Mendimi juaj?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Mendoj se përmasat e elefantit, në këto kohëra, janë të papërfillshme në krahasim me numurin dhe babëzinë e krimbave. Nga ana tjetër, duke lënë mënjatë shakatë, më duket se Hegeli ka pasur një besim ca si të tepruar në krimbat. Ndoshta nuk ka ditur cili është krijuesi i elefantit.

(vijon në faqen 7)

dimet për doktoraturë në teologji dhe u specializova në shkencat humane dhe të komunikimit, ku nisa edhe karrierën universitare.

**- Cila ka qënë prirja juaj në shkollën e mesme? Ishit më të dhënë ndaj lëndëve shoqërore, apo shkencore?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Prirja ime e vetme në atë kohë ishte si t'i mbijetoja duke jetuar sa më hijshëm kalimit drobitës nga Pogradeci (lexo: femëria e kulluar) në Tiranë (lexo: rinia e pafilluar).

**- Formimi letrar për çdo nxënës bëhet gjatë shkollës së mesme. Çfarë librash keni lexuar atëhere?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Shumë libra. Gjatë pushimeve që i kaloja në Pogradec, lexova qysh herët "Plaku dhe deti", "Hamleti", "Makbethi", "Ylli i zemrës", "Rubajitë" e Omar Khajamit, prozë nga Drajzeri, Remarku, Tolstoi, disa libra të ndaluar etj. Im gjysh pat murosor njëherë nga dritaret e dhomës ku flija dhe e pat shndërruar në bibliotekë. Në Tiranë, sidomos kur dyndeshin shirat, lexoja prozë nga Kuteli, Gogoli, Balzaku, si dhe shumë poezi.

**- Çfarë gjuhë të huaja keni mësuar?**

**Ardian-Christian Kçyçku:** Nuk mund të thuash se "ke mësuar" një gjuhë. Është si të ngulmosh se ke mësuar një njeri të gjallë. Ç'është ky lloj mësimi?! E shumta mund të gërshetosh kujtesën, kohën dhe frymën tënde, herë më fort e herë më përgjumshëm, me rrjedhën e një gjuhe të huaj. Gërshetime të tilla më ndihmoi të bëj im atë, qysh në fillore. Dy metoda të italishtes, dy të frëngjishtes, pastaj nëntë vjet rusisht në shkollë, dy vjet latinisht në fakultet. Po nën drejtimin e tim eti, këra një metodë të shkëlqyer të rumanishtes, në vitin e parë të fakultetit. Më tej ndoqa për dy vjet gjermanishten në Bukuresht, dhe disa periudha të gjata, me, ose pa mësues, në anglisht.

**- Ç'është për ju rinia?**



Prof. Ramazan BOGDANI

(vijon nga numri i kaluar)  
**VALLET E BURRAVE.**

Shfaqjen më tipike të vallëzimit të burrave të Mokrës e përbën vallja dyshe. Ajo përfaqëson një tip kërcimi që shtrihet në një trevë të gjerë, siç është Toshëria. Si rrjedhojë e një praktikimi të tillë, vallja dyshe e burrave të Mokrës edhe dallon për nga tiparet dhe struktura arkitektonike në krahasim me ato të krahinave të tjera të së njëjtës trevë. Madje, edhe brendapërbrenda Mokrës, vallja dyshe bart ndonjë veçori nga fshati në fshat, sikundër edhe nga njëri kërcimtar të tjetri. Këto sigurisht që kushtëzohen edhe nga bota e brendshme shpirtërore dhe individualiteti krijues i valltarëve interpretues. Sipas traditës vendase, ky tip vallëzimi përgjithësisht praktikohet nga banorë të besimit islam.

Vallja dyshe e burrave, duke qenë se shoqërohet me këngë, luhet e kënduar nga dy valltarë-këngëtarë, ndërsa grupi (tre-katër ose më shumë) qëndrojnë në vend dhe "mbajnë zë".


Nga pikëpamja e trajtës ky tip kërcimi është dypjesëshe: e shtruar dhe e prerë (kthesa) e valles. Në të shtruarën kërcen kryesisht valltari i parë, ndërsa i dyti e mban për dore të parën, por duke lëvizur paksa pas tij. Tek e prera e valles luajnë që të dy njëherësh. Si zakonisht, të moshuarit (dhe këta në Mokër janë të shumtë), në krahasim me më të rinjtë e interpretojnë atë më qetë, por me një duf të brendshëm.

Tek e shtruar valltarët janë të kapur për duarsh duke kërcyer në vend dhe me zhvendosje në rreth nga e djathta, kryesisht nëpërmjet motiveve dyhapësh, për rastin e parë, dhe shumëhapësh për rastin e dytë. Përgjithësisht tek e shtruar, në strukturën koreografike vërehen ngjasime të afërta me zonën e Rajcës, me të cilën Mokra e Poshtme është në kufi. Tek e prera valltarët shkëputen nga njëri tjetri, bëjnë hedhje e ulje të thella mbi të dyja këmbët; veçanërisht bien në sy shkëmbimet dhe uljet e tyre me supe të kundërta.

Përgjithësisht interpretuesit e valleve dyshe të Mokrës janë mjeshtra të vërtetë. Veçanërisht në këtë drejtim na tërheq vëmendjen virtuoze të interpretuar dhe të ekzekutuar i valltarit 83 vjeçar Hasan Rusho nga fshati Çezma e Madhe. Ky, së bashku me Feta Cano dhe një grup burrash të cilët "mbajnë zë" dhe që janë nga i njëjti fshat (Çezma e Madhe), luajtën vallen e kënduar "Moll" e kuqe mi avli" 5. Veç dy të parëve, valltarët e tjerë, sipas rradhës, janë: Faik Kastrioti (1930), Hilmi Kastrioti (1935) dhe Vaid Kastrioti (1936) (Skeda 14; Kf. 34/10; Ff.2607/61-73, 2608/3-13; Fonot. 1207/17).

Siç u tha, në këtë valle shquan Hasan Rusho, i cili, ndonjëse i moshuar, shpreh ekspresivitet të dukshëm në të vallëzuar. Kërcimi i tij është në trajtë dypjesëshe.

# 17-25 korrik 1975, ekspeditë



Jonuz Korça (1908, Debravë) dhe Hamid Korça (1930, Debravë) mbajnë zë Bari Lela (1911, Slatinë), Hysen Metushi (1912, Slatinë), Jonuz Balliu (1936, Slatinë) dhe Qazim Korça, 1972

Në të shtruarën ai zhvendoset me hapa thujtë të thjeshtë, ndonjëse dallohet edhe një ulje e fortë mbi të dy këmbët. E prera e valles shfaqet shumë e gjallë. Spikasin të theksuarit e hapave, ndale-

sat e herëpashershme për t'i dhënë forcë zërit, rrahjet me duar të gjoksit dhe të ballit, përkuljet e trupit prapa (urë) afër tokës dhe ngritja e menjëherëshme e tij, gjë që shënon një figurë karakteristike. Larminë

e kësaj valleje e shton edhe teksti poetik i këngës përcjellëse me njëfarë përmbajtje lozonjare.

E një strukture të tillë paratitet afërsisht edhe vallja dyshe e kënduar, titulluar sipas vargut

të parë "Hiç për gja, s'ta kam zilinë". U ekzekutua nga një grup burrash nga fshatrat Debravë (Bari i bardhë) dhe Slatinë. Në krye është dyshja Jonuz Korça (1908, Debravë) dhe Hamid Korça (1930, Debravë) mbajnë zë Bari Leka (1911, Slatinë), Hysen Metushi (1912, Slatinë), Jonuz Balliu (1936, Slatinë) dhe Qazim Korça (1933, Debravë) (Skeda 1; Kf. 33/2; Ff.2605/7-23; Fonot. 1207/4). Tipike për këtë valle është se e para shfaqet më e shpejtë, ndërkohë që valltarët, duke qenë të shkëputur nga njëri tjetri, bëjnë ulje të thella mbi të dy këmbët.

Nga i njëjti grup burrash kemi regjistruar vallen "Djali vogël jaxhami" (Skeda 2; Kf. 33/9; Ff.2605/25-41; Fonot. 1207/5). Duke qenë se dyshja e valltarëve, në krahasim me më sipër janë me të rinj në moshë (Jonuz Balliu dhe Qazim Korça) në kërcim zotëron njëfarë gjallërie më e madhe në krahasim me të njëjtin tip si "Hiç përgja...".

Për të njëjtën strukturë kërcimi shquan edhe vallja e kënduar "Ç'të shtiva për në firan", që e regjistruam në fshatin Kriçkovë dhe që u luajt nga një katërsh burrash po nga ai fshat dhe një tjetër, Homçan. Dyshja kryesore përbëhej nga të moshuarit Abaz Xhambazi (1899, Homçan) dhe Rahim Xhambazi (1907, Homçan), ndërsa "mbajnë zë": Nuri Kollogri (1940, Kriçkovë) dhe Veli Fezollari (1912, Kriçkovë) (Skeda 7; Kf. 34/4; Ff.2606/5-21; Fonot. 1207/10). Gjatë këtij kërcimi bien në sy për të mirë disa nuancime lëvizjesh: ulje me gjuhë dhe kapje për krahësh të kundërt, zhvendosje nga e djathta si edhe ulje të thella me hedhje mbi të dyja këmbët etj.

Kërcimi dyshe i burrave mokrarë shfaqet edhe gjatë ekzekutimit në grup, gjë që përbën një formë të zhvilluar, të krijuar me kohë nga vetë bartësit. Shembull do të përbente vallja e kënduar "Shtro dysheknë rrumbullak", që u ekzekutua nga një grup burrash nga fshati Velçan me në krye dyshen Harun Elezi (1912) dhe Mislim Lufo (1929); në vijim me Hamid Sulosi (1936), Hazis Misliu (1935), Demir Biba (1932), Kodhel Hyko (1940) dhe Pëllumb Lufo (1949) (Skeda 9; Kf. 34/2; Ff.2606/43-55; Fonot. 1207/12). Tek e shtruar, grupi i pjesëmarrësve e nisi kërcimin në formacion gjysmërrethi, të zënë për dore dhe me zhvendosje në varg nga e djathta. Këtu shfaqet një ecje me hapa të lirë. Në vijim të së shtruarës dhe të prerës së valles, dy valltarët e parë shkëputen nga grupi dhe kërcenë me vete sipas tipit të mirëfillt të valles dyshe, ndërkohë që burrat e tjerë mbledhen grup në vend dhe "mbajnë zënë" e këngës. Tek të dy valltarët, veç të tjerash, dallojnë uljet e thella me qëndrime për pak çaste pa lëvizur. Në të prerën valltarët bëjnë rrotullime me kahe të kundërta, por edhe ulje të thella, të palëvizshme si në figurën e parë<sup>6</sup>.

Këtë tip kërcimi, madje me ngjyra më të larmishme, e hasim tek një grup burrash nga fshatrat Kriçkovë e Homçan, nëpërmjet njësisë "Çaste nga ceremoniali - berberi që rruan mbrenë". U ekzekutua nga dyshja kryesore Nuri Kollgini (1910, Kriçkovë)

# koreografike në zonën e Mokrës

dhe Veli Fejzollari (1912, Kriçkovë), në vijim të grupit me Abaz Xhambazi (1889, Homçan), Veli Fejzollari (1912, Kriçkovë) etj. (Skeda 8; Kf. 34/7; Ff.2606/23-39; Fonot. 1207/11). Veç të tjerash, ky rit, që është i njohur edhe në shumë krahina të tjera, në Kriçkovë të Mokrës patëm rastin ta filmonim në prani të shumë njerëzve përreth, duke u krijuar një mjedis origjinal me këngë, valle dhe veprime rituale që përfaqesin me ceremonialin e dasmës.

Sipas atij ceremoniali, ndërkohe që njëri në rolin e berberit bën sikur rruan një tjetër në rolin e dhëndërit "mbrenë", burrat përreth kërcëjnë, duke u shkëputur dy të parët. Gjatë këtij rituali të pranishmit e tjerë lëvizin lehtë me ecje hapash nga e djathta. Kërcimi i dyshes, nga Nuri Kollgjini dhe Veli Fejzollari, është i tipit të valles dyshe me të shtruarën dhe të prerën. Sipas regjistrimit në përfundim të kërcimit nis të këndojë një grup grash këngën "Dhëndëri zinxhir ergjendë".

Megjithëse në strukturën e valleve dyshe të burrave, krahas elementëve të çeta e të shtruarave vërehet edhe ndonjëfarë force, veçanërisht në të prerën e valles, këto njësi, nga pikëpamja tematike, i përkasin gjinisë lirike (aty këtu mund të përfshihen edhe në vallet liriko-epike). Kjo dukuri kushtëzohet edhe nga përcjellja me tekstet poetike të kënduara të cilët, gjithashtu, janë lirike dasme, erotike etj. Të tilla përmendim: "Ç'të shtiva për në firan", "Hiç për gja s'ta kam zilinë", "Djali vogël jaxhamii", "Moll e kuqe mbi avlli" etj.

Një veçori karakteristike për tipin e valles dyshe të burrave përbën një kërcim i tillë në fshatin Velçan i cili, veç formës së mirëfilltë me këngë, praktikohet edhe i shoqëruar me lodër. (Ky lloj shoqërimi është karakteristikë kryesisht për fshatrat Stravaj, Manastirec dhe Stranik të Librazhdit me të cilët Velçani është në afëri dhe ka patur lidhje martesore). Një njësitë kësaj natyre e filmuar nën titullin "Valle dyshe burrash e Velçanit". Ajo u ekzekutua nga Hazis Misliu dhe Demir Biba (shih skedën 9), të përcjellë me lodër nga Bexhet Rapça (1946, Velçan) (Skeda 10; Kf. 33/5; Ff.2607/57-73; Fonot. 1207/13). Lidhur me përcjelljen me lodër do theksuar fakti se sipas bartësve dhe gjurmëve tona qysh herët ai instrument është praktikuar në Velçan për thirrjen dhe grumbullimin e popullit, me që ky fshat nga pozicioni geografik është tepër i shpërndarë. Rrjedhimisht, vallja dyshe e burrave të fshatit të Velçanit e shoqëruar me lodër njihet tanimë nga vendasit dhe nga ata të fshatrave dhe krahinave përreth si pjesë përbërëse e shtratis koreografik të këtij fshati (me këtë tip valleje Velçani ka marrë pjesë në një sërë festivalesh folklorike në bazë zone dhe rrethi).

Pavarësisht nga përcjellja me lodër, kërcimi priret nga struktura e valles dyshe të kënduar. Tek e shtruarat valltarët luajnë përdore, ndërkohe që hapat shfaqen me njëfarë zhvillimi. Kurse në të prerën ata kërcëjnë me së shumti të shkëputur nga njëri-tjetri, duke u zhvendosur në rreth nga e djathta, si edhe me kryqëzime të rastit.



Vallja e kënduar "Ti berber qe rruan mbrenë", Kriçkovë | 1975

Gjatë ekspeditës së Mokrës -korrik 1975 volëm edhe një sërë të dhënash të tjera, si për shembull, për vallet e gjinisë lirike humoristike ("Vallja e piperit"), lirike koreopantomimike ("Plaku i dasmës") etj. Gjithashtu gjurmuam dhe për festat me karakter shoqëror e ritual kur janë praktikuar vallet ("Llazoret", "Koledrat", "Vangjelizmoi" etj, e deri tek festat më të reja).

Përmes hulumtimit, na u krijua mundësia që me një grup vajzash nga fshati Pleshisht, të filmojmë vallen "Qan Minushi". Ekzekutueset janë po ato që luajtën tri baladat e mësipërme. Në krye të vargut është Dhimitrie Maçellari (Skeda 20; Kf. 33/7; Ff.2609/21-55; Fonot. 1207/23). Edhe pse e përcjellë me një tekst poetik me përmbajtje tradicionale, vallja i bën jehonë pikërisht asaj njësie që është praktikuar gjerësisht gjatë periudhës dhe pas Luftës së Dytë Botërore. I përket një shtrati të gjerë të zonave të Shqipërisë së Jugut dhe kërcëhet zakonisht me motivin asimetric me 4+2.

Ashtu si në çdo ekspeditë, edhe në Mokrë nuk lamë pa gjurmuar risitë folklorike në përgjithësi, të diktuar nga jeta bashkëkohore. Këto duken më së shumti tek përmbajtja e re e teksteve poetike të këngëve përcjellëse, si dhe tek njëfarë interpretimi që shfaqet më me gjallëri. Në këtë spektër përmendim edhe ndonjë njësi koreografike të cilin e bëmë objekt edhe përmes regjistrimit filmik. Një i tillë është vallja "O moj Mokra heroike", që u ekzekutua përmes motivit të zakonshëm asimetric nga një grup vajzash të shkollës 8-vjeçare të fshatit Pleshisht. Në krye të vargut është Adriana Maçellari (1962), dhe më radhë: Marjeta Spirollari (1961), Meri Spirollari (1960), Roza Spirollari (1960), Vasilika Maçellari (1962), Fonika Maçellari (1962) (Skeda 21; Kf. 33/8; Ff.2609/27-34; Fonot. 1207/24).

\*\*\*

Këto do të ishin disa nga rezultatet e ekspeditës së Mokrës së Pogradecit më 1975. Analizat përkatëse u trajtuan duke pasur objekt tërësisht 21 njësitë ko-



reografike të regjistruara përmes filmimeve, incizimeve të përcjelljeve muzikore dhe fotografimeve të tyre 7.

\*\*\*

Lënda e mbledhur gjatë ekspeditës së Mokrës u sistemua mbi bazën e re të kriterëve shkencorë për arkivimin e njësive koreografike të mbledhura në terren. Kështu u përgatit:

- 1- Lista e repertorit të 21 valleve të filmuara.
- 2- Skedat e valleve në tri të tilla, skeda për tekstet e kënduara përcjellëse.
- 3- Skedat e ekzekutuesve të valleve.
- 4- Relacioni rreth rezultateve të ekspeditës.
- 5- Skenari i kinofilmit: "Valle nga krahina e Mokrës", në dy pjesë, Kf.nr.33 dhe Kf. nr.34. Këtu si në çdo tregues të tillë shënohet rreshtimi i valleve sipas kriterëve shkencorë e artistike dhe, për çdo valle, zbardhet emërtimi, ekzekutuesit dhe shoqërimi muzikor.

Gjithashtu, ashtu si në gjithë rastet e ekspeditave në terren, në dosjen përkatëse, nr. 11, janë përfshirë edhe dokumentacione me karakter organizativ të ekspeditës.

\*\*\*

Për ta pasur më të gjërë lëndën koreografike nga krahina e Mokrës, do të shtojnë edhe ndonjë dukuri si rrjedhojë e kërkimeve dhe shënimeve tona gjatë ekspeditës së parë më 1972 (foto 5). Paraprakisht, duhet bërë me dije se ekspedita pati karakter

Në mbyllje të këtij artikulli do të shtonim se për njohjen dhe popullarizimin e valleve të Mokrës organet të pushtetit të rrethit të Pogradecit kanë organizuar një tubim me autorin R. Bogdani për njohjen e valleve të Mokrës<sup>9</sup>.

.....

1) Për njëfarë larmie po shënojmë disa vargje nga teksti poetik i këngës përcjellëse të valles "Zinxhirit në grykë":

Bardhule, ballët me lule,  
moj bardhule \*  
Ç'je nisur kësaj rruge.  
Qo rrugë ka zahmet,  
të kërkon hanko hyzmet...

\* Refren që përsëritet pas çdo vargu.  
2) Po shënojmë tre vargjet e para nga teksti i këngës përcjellëse të valles "Më rrëmbu gegë çobani":

Më rrëmbu gegë çobani,  
më rrëmbu, më çoi ndër male,  
më veshi xhokën e madhe...

3) Teksti poetik përcjellës i valles "Plak more, djal more":

Ç'u nis plaku dhe djali,  
plak more, djal more! \*  
Të dy bashkë në një rrugë.  
Gjetën një vashë të re.

Djali thoshte ta marr unë,  
plaku thoshte ta marr unë.  
Vasho thoshte: plak se dua!  
Shtinë shortë kuj t'i bjerë;  
shorti ç'i ra plakut-o.  
Zuni plaku po këndonte,  
zuri djali po vajtonte,  
Vasho thoshte: "plak se dua..."

\* Refren që përsëritet pas çdo vargu.  
4) Disa nga vargjet e tekstit poetik të këngës përcjellëse të valles "Maxhë të thrrët jotëmë":

- Maxhë të thrrët jotëmë,  
jamana, jamane, \*  
Le të thrrasë sa të dojë,  
kush i tha të më martojë!  
Më martoi të vogël-o,  
më dha burrin 40 vjet;  
un' e mjera dymbdhjet vjet...

\* Refren që përsëritet pas çdo vargu.  
5) Teksti poetik i këngës përcjellëse të valles "Moll' e kuqe mi avlli":

E shtruarë: Moll' e kuqe mi avlli,  
hedhur degët mi çati,  
këput lule fut në gjë,  
m'i fshin djersët me shami.

E prera: Po, djerskat e ballit,  
er e portokallit;  
po djerskat e gushës,  
si lulet e fushës.

6) Gjatë hulumtimit në fshatin Velçan, veç valles objekt filmuam dhe një tjetër; të dyja të ekzekutuara nga burra. Por, në vatrën e kulturës të fshatit ku ishim mbledhur fillimisht, një grup vajzash të pranishme luajtën disa valle, të cilat nuk i regjistruam sepse kishin pothuajse të njëjtat karakteristika si të tjerat e filmuara. Megjithatë, do të veçoja disa tituj valle të kënduara, si: "Moj e vogla në lëmë, / Se ç'të ndritën ato llerë", "A të erdhi keq, moj esmerk e vogël", "Çeli trëndafil s'bëra me shëndet", "Ky dimri sivjemë me shi, me dëborë" etj.

Në bashkëbisedim për këto probleme dhe më gjerë me ngjallën interes gratë e moshuara Nurie Biba (1888, fshati Strank) dhe Servete Biba (1905, fshati Kotodesh). I tillë ishte edhe i moshuari Jaçe Biba (1895, Velçan).

Madje, do të shtoja se nga filmimet e ditës dhe bisedat e zgjatura na zuri nata dhe shkuam të flejmë në Bishnicë, një vendbanim i vogël për punëtorë të sharrave të druve (më 22 korrik 1975).

Si në të gjitha rastet e organizimit të ekspeditave në terrene të vështira malore, edhe në Mokrë kemi fjetur më së shumti nëpër baza. Të tillë kanë qenë fshatrat Podgozhan, Pevelan, Velçan etj.

(vijon në faqen 8)



# Haydutët e Valamarës

Tregim nga Istref HAXHILLARI

(vijon nga numri kaluar)

Guri binjakëzohej pashmangësisht me jetën e njeriut, prej fëmijërisë së hershme deri në vdekje dhe më tej, pasvdekjen e amëshuar. Fisi adhuronte gurin, pa ditur se kështu i faleshin të tjerët Zotit në gjithë botën që nga koha e Krishtit dhe Muhamedit. Në shekujt që rrodhën më pas asnjë fe nuk zuri rrënjë, aq më pak bota kuranike nuk u ngjiz dheut të fisit në shtatull të malit.

Prijësi nuk mori pjesë në ndarjen e presë. S'ishte punë e tij. I ngrysur me vështrim tretur në largësi, në mbështet mbi fronin e gurtë. Aty qenë ulur kohëve të shkuara të tjerë prijës. Një buzëqeshje fluturake dhe diellore rrezatoi nëpër tiparet e rëna si gjithnjë kur përkundej në fronin e lashtë. Tiparet e dëshirës së përmbushur.

- Punë e pastër. Mishi i Dragotinës mban vendin e parë, - iu drejtua Mali, më plaku i fisit. Kishte kapërcyer prej vitesh shekullin, po mbahej i fortë e i kthjellët.

- Nuk e patëm vështirë, njerëzit që kallzuan qenë të saktë, - i foli Nepërka burrit të moshuar. Pastaj e ngacmoi si përherë në orët e mira.

- Ti Mali nuk ke ndërmend të vdesësh ndonjëherë?

- Vdekja nuk më tremb, po shpirtit nuk i është mërzuar ende trupi im, - u përgjigj gjysmë buzëqeshur plaku i urtë mbuluar me rrudha të thella si brezaret e vendit.

Prijësi vështroi i menduar tutje honeve të Kurorës. Fisi i tij shpërfillte vdekjen, askush nuk e mendonte. Asnjë burrë apo grua nuk kishte frikë prej saj. Filozofia e pangjashme me asnjë tjetër, zinte fill në bashkëjetesën e vazhduar me vdekjen. Në vendin e fshehur mjeshtrë isht në gjoks të maleve, vdekja ishte po aq e pranishme sa jeta. Dallimi mes tyre që i zgripët, ndaj ata besonin se vdekja nuk ekzistonte si zhbërje shteruese, po vetëm kapërcim në gjendje ndryshe, pas të cilit shpirti vendosej në trup tjetër, pastaj tjetër, gjer në pafundësi.

Fisi besonte se gjithsecili mbante në trup shpirtin e dikujt më të lashtë, marrë nga tjetër paraardhës në trajtë vargu të zgjatur trashëgimie. Prej kohësh tejet të largëta, valamarasit besonin në udhëtimin e shpirtit të pavdekshëm. Besimi i lashtë largonte frikën e pasvdekjes, ndaj askush nuk e përfillte kalbjen e trupit ndër kallur në tokë. Shpirti do të jetonte një lloj si më parë. Nepërka besonte se shpirti i paraardhësve të vjetër kishte udhëtuar në gjashtëmbëdhjetë prijës para tij. Mbi këtë besim që gatuar sjellja e pashembullt. Pavdekësia ishte droga e fortë e guximit të harbuar guñehiri.

E tillë ishte Valamara, me bukuri të egër prej virgjëreshë, banorë të sertë e të pashëm, besim të çuditshëm për transferimin e shpirtit, veçan të tjerëve në tërë hapësirën e pamatë prej Korçe gjer në Elbasan.

Nënë Gjera i solli një kupë verë mjalti, ndërsa krahëqafë mbante lëkurën e qengjit mbushur me lëngun e verdhë dyllë.

- E kam gatitur vjet nga mjalti i Kurorës, është pije për mbret. - E qeshur i zgjati gotën e mbushur gjer në buzë.

Prijësi buzëqeshi. E ndjeu veten mes njerëzish që e donin dhe i donte. Shpirti i tij u zbut si shajak rrahur nëpër dërrastilat e Shkumbinit.

- Asnjë grua nuk di të tharmëtojë verë si ty nënë Gjera, - i bëri qejfin plakës.

- Kujt ia ke mësuar më mirë? - pyeti, si pui një gllënjë nga kupa e saj.

- Të gjithëve, po nuk është e lehtë, - u përgjigj plaka. - E fshehta qëndron te përzierja e mjaltit me lëngun e gjembit të ariut dhe trazimi i gjatë nëpër gypat e baltës sonë. Këtë e ka mësuar Vesa më mirë nga të gjitha. Shtat-arakja është shumë e hollë.

Nepërka treti vështrimin mbi Kurorë, mbuluar me pyje dhe shkëmbinj pa fund. Fjalët e nënë Gjeres dhe vera e mjaltit nxitën fantazinë. Përpiqej të zhbironte historinë e veçantë të vendit të tij, e pangjashme me asnjë tjetër përreth.

- A nuk të duket çudi Valamara jonë? - pyeti plakën.

- Valamara është e vërtetë, të tjerët janë çudi e pakuptuar, - kundërshtoi me bindje të

plotë nënë Gjera. - Pasuri e vendit tonë janë pyjet, kuajt dhe bletët. Kuajt i rrisim vetë, bletët pylli. Djemtë i kemi mjeshtrë të vjeljes së mjaltit nëpër trungjet e aheve të stërvjetër dhe guvat e shkëmbinjve të Kurorës. Ne jetojmë me bletët, ashtu si të parët tanë. Mjaltin e kemi ushqim, ilaç për sëmundje, pije për gosti e vdekje. Vetëm ne dimë magjinë e fermentimit të verës prej mjalti përzier me kokrrat ngjyrë vishnje të fllambës. Asgjëkund nuk përgatisin verë të tillë. Ne jemi të vërtetë, ashtu si duhet të jenë njerëzit.

- Nuk mjaftojnë, janë pikë uji në det, - ia ktheu plakës Prijësi i menduar. - Gjuetia nëpër netët e gjata mban fisin tonë. Po ti ke të drejtë, ne jemi të vërtetë, jo ata.

Tundi kokën si të shkundte mendimet e ngarkuara. Ditën, fshehur nëpër zabele, kishte parë njerëz përkulur sipër parmendës, shatit apo drapërit. Kullonin djersë, drobitur kockë e lëkurë. Të gjithë ngjanin pleq. Gratë nën barrën e ngarkesës ecnin mundimshëm, të rrëgjua e sflitura. Këtë jetë nuk do ta pranonin kurrë njerëzit e tij.

- Më thuaj o plak si jetojnë të tjerët? - iu drejtua Malit.

- Ti e di. Kam parë vende të largëta, ku nuk ka shkelur askush prej fisit. Kam parë njerëz të pasur sa s'bëhet, rrethuar nga shërbëtorë. Kam dëgjuar për të tjerë që hanë me lugë floriri. Të gjithë këta janë fare të paktë, pikë uji në det. Shumica vuajnë llahtarisht, robtohen pa fund në punë sflitëse. Kjo jetë nuk bën për ne. Jemi tjetër racë, kemi të tjera sjellje.

Vetëm në Valamarë të gjithë jetojnë një lloj të barabartë mes të barabartës. Askush nuk është i pasur, askush nuk ka më tepër se të tjerët. Ne nuk e njohim skamjen, as varfërinë. Kjo është jeta e vërtetë e njeriut, tjetra nuk është jetë, por çapitje e marrë. Më thuaj ç'farë ke më shumë se cilido burrë i fisit tënd? - përfundoi Mali.

- Asgjë. Si mund të kem më tepër kur gjithçka ndahet barabar? - u përgjigj i habitur me çiltërsi fëmijë Nepërka.

- Drejtësia dhe besimi janë shtyllat e Valamarës. Vajzat e rrëmbyera nuk duan të ikin se e dinë mirë jetën e atjeshme. Vesa thotë se në Shtat nuk do të kthente as kokën për të parë.

- Kemi mbetur vetëm, - vazhdoi të tinte mundimshëm filozofinë e fisit, - të tjerët janë shumë më tepër. Ata nuk i tremben forcës sonë as pjerrësive thikë të Kurorës, siç kujtojmë ne. Më shumë frikohen nga jeta jonë. Shembulli ynë është i rrezikshëm për njerëzit që jetojnë mes bollëkut dhe sundojnë gjindjen. Ky rrezik është forca e Valamarës, prandaj na durojnë duke shtrënguar dhëmbët sa herë u bien në qafë, - shtoi i menduar plaku i urtë.

Pastaj vazhdoi.

- Kurora e Valamarës ka jetë dhe vdekje. Ata kanë edhe lëngatë. Njerëzit e sëmurë nëpër botë kapërcenjë të shëndoshët, ndonëse janë shumë më pak se të vdekurit. Kam parë lebrozë të mjerë tërë dregëza, astmatikë që nuk ngopen kurrë me frymë. Ç'nuk kam parë! Ne s'lëngojmë kurrë. Maja e Kurorës dy muaj gjelbërohet, kohën tjetër zbardh prej dëborës gati të përjetshme. Burimet e ujit të kthjellët me veti shëruese rrjedhin vetëm në Valamarë, asgjëkund tjetër. Tek ne moshja shtatëdhjetë vjeçare, nëse nuk e korr më parë thika apo plumbi, përballon një lloj të breznitë më të reja rrëpirat e ngatërruara të jetës. Askund nuk ndodh si këtu. Përreth bota është e kalbur, e sëmurë, e prishur si kokrrat e fllambës së shkullur.

Prijësi bluante mendueshëm arsyetimin e njohur të Malit, filozofinë e lashtë të Kurorës. Sidoqoftë donte ta dëgjonte gjithnjë.

\*\*\*

Valamara përtypte ditët me nofulla shtrënguar. Shkeli dimri me dëborë dhe furtunë, ortekët dhe okidën e palëvizur muaj me radhë. Bardhësia e ftohtë bllokonte rrugët dhe gozhdonte njerëzit në strehët e tyre të gurta.

- Erdhe më në fund? - Neridi e zuri për dore gruan e re.

Krenta e gjerë, zaptuar prej mallit, ia kishte mbathur përmes territ dhe ftohtësisë. Ishte nusja e errësirës, bijë e natës që nuk guxon të ketë foshnjën e argjentë të ditës. Mardhur nga moti zemërak i Valamarës, ndezur prej vullkanit të

shkumbëzuar së brendshmi, shpirti i tallazitur merrte arratinë ëmbëlcake në gjë të malit.

- Mos të duket e lehtë? - fërgëllloi me buzët nxirë prej të ftohtit.

- Po e zgjatim shumë, do ta vras, - kumtoi djaloshi i ngrysur, i vendosur të çonte deri në fund ëndrën e harbuar.

Krenta e vështroi me dhembshuri. Dobësi femre dhe nëne. Dhjetë vjet më shumë se ai, vetëm tani përjetonte thelbin e dashurisë ronitëse, ndonëse në kufijtë e së pamundurës. Ndiente me kthjellësi marramendëse në Nepërkën nuk e kishte dashur asnjëherë. Vite të tëra shkruar dëm, humbuar në një jerm kapitës. Rinia e hershme, xhevahir i tretur kotësie. Nënshtruar në fatin e saj, plotësonte dëshirat e femrës, krenohej me adhurimin e burrit më të fuqishëm të fisit. Të tjerat ëndëronin jetën e pazakontë mes burrave. Ajo tani e urrente. Trishtimi i vazhduar errësonte shikimin. Sytë e mëdhenj të zinj e kishin humbur ndriçimin e platintë. Pushteti i hijeshisë femërore ronitej në bunacën e dallgëve të potershme.

- Nuk do ta bësh. E njoh mirë, s'i thonë Nepërkë vetëm për blanën e thikës në fytyrë. E ka nuhatur prej kohësh lidhjen tonë, e ndiej, - psherëtiu e ligështuar.

Djali i mori kokën me duar të dridhura, ia ngrohu buzët e mpita. Puthje e nxehtë e shpirtit të robëruar. Ngulmi i çartur, mundësia e vetme që e shpinte drejt përjetësisë, shpërfillte filozofinë e thijnur të vendit. Sfida e tij ishte krisje e thellë e ekzistencës së motshme valamarase, çarje e gjirit të Kurorës, përbaltje e gurëve dhe pyjeve të adhuruar përjetësisht prej fisit.

- Do ta vras, pastaj nuk ndahemi kurrë.

Krenta uli kokën. Neridi që shumë i shtrënjtë për të. Përndiente tendosjen e djalit, teksa shtëngohej të pranonte hapur ledhatimet e Nepërkës. Nuhati kuptimin e çoroditur të pyetjes në Koziç. Ai nuk duronte pamjen e duarve të tjetrit në leshrat dhe trupin e saj. Duart e plakura të trandura nga pandehma e humbjes në një betejë të pabarabartë iu neveritën, kapërcyen pikën e ngopjes, prekën cakun e padurimit. U mendua një copë herë pastaj vështroi e këndellur siluetën e shtrënjtë të djalit.

- Të largohemi nga Valamara. Në Shtat te njerëzit e Vesës fshihemi për ca kohë, më tej shohim e bëjmë.

Neridi e dëgjoi me vëmendje. Fytyra e vvarë i shkëlqeu. E kishte menduar gjatë këtë mundësi, po nuk besonte se gruoja do të pranonte braktisjen e vendit të tyre. Futi dorën e dridhur nëpër leshrat e ngatërruara të Krentës, ledhatoi me ëmbëlsi fytyrën, trupin e hijshëm, gjoksin, e shtrëngoi fort pas vetes i malluar.

Arratisja nga Kurora do të thoshte shumë. Humbje e lirisë, humbje pa kthim e jetës së vërtetë. Me dëshirë do të pranonin jetën tjetër, nënshtrimin pa kushte, që e urrenin të gjithë. Nuk kishte ndodhur të arratisëj njeri prej Kurorës, për çfarëdo arsye, në çfarëdo rrethane. Vesa dhe të tjera vajza, rrëmbyer ngado, e dinin mirë jetën përtej Valamarës, punën e mundimshme të vazhduar, urinë e përditshme, sëmundjet dhe vdekjet pa numër, që pllakosnin dendur. Më shumë se gjithçka rëndonte për-buzja, dhuna dhe shpërfillja. Andej i rihnin gratë si kuajt e pashtuar, i nëpërkëmbnin dhe masakronin. A do ta pranonte këtë Krenta?

Kurora shkëlqente me bukuri rrezëllitëse, sa hante syri pa fund e pa anë. Njeriu nuk mund të përfytyronte as fillimin dhe as fundin e Valamarës. Horizonti niste e firohej përmes saj. Dëborra kishte zburuar pyllinajën me shtrirje të tej jetshme. Bredhat gjigandë hera - herës shkundnin krifën e gjelbër prej ngarkesës së rëndë të mikeshës së lashtë shtruar në shtëpinë e saj.

Neridi ngriti për një çast kokën dhe humbi vështrimin në pafundësinë e vendit të tij.

Krenta apo Valamara?

Duart e dridhura nga thirrja e gjakut depërtuan në çdo pjesë të trupit femëror që fërgëlonte ethshëm. Çdo pore e lëkurës së saj, prush i këndellur, shqisë drithëruese marramendëse, tallazitje e shpirtit të munduar. Ajo ndiente preken që i lëpihej pas trupit, barkut, krahëve, kofshëve, gjer thellë shpirtit të uritur. Nuk donte të largo-

hej për asnjë çast nga përmezja e pacak.

Sidoqë pjesa femërore e saj nuk shqitej, në këndellje parandieu e para rrezakun lemerisës, që mund të ishte diku përreth, i padukshëm, ronitës. Ndjeshmëria ligështuese e femrës. Me përpjekje tinzare, të mundimshme u shkëput prej përqaimit.

- Largohu nga çesma e nuses shpejt, - tha me vendosmëri, kur pikasi sytë e përlotur të djalit.

Neridi dalloi nëpër natë hijet vrastare. Vezullim i çastit apo vegim i mendjes së përngritur? Ndoshta të dyja bashkë, kapërthyer në trajtën e kokës së zmadhuar të Nepërkës.

- Jo, mos ikë, - pëshpëriti, - tani nuk mund të kthehem pas!

E zuri dhunshëm për dore, gruoja e ndoqi. U zhdukën në errësirë. Hijet u vunë pas. Zuri fill një dyluftim i dëshpëruar, i patëdytë. Nepërka dhe Gurani dihatrin pa ndërprerje. Ndjekja vazhdoi gjatë. Në shpirtin e prijësit luftonin dy genie krejt të kundërta, burri i tradhëtuar dhe burri i zhuritur së brendshmi, fuqia dhe dobësia, nderi dhe turpi.

- E dua të gjallë, - i tha besnikut të tij, - mëlçinë do t'ia ha pa pjekur në sy të gjithë burrave.

Në përndjekjen e natës, Krenta nuk ekzistonte, Neridi po. Gruaja do të binte sërisht në gjuhë dhe ai do të përkëdhelhe si gjithnjë flokët e saj të rëndë. Përjetonte çastin e vdekjes së djalit. Do t'i hapte barkun me thikën e harkuar për të nxjerrë mëlçinë e gjakosur. Fisi ishte me të, vjedhësit e valamarësve dënoheshin me vdekje. Mes tyre nuk ekzistonte vjedhja. Sa i fortë instikti i rrëmbimit ndër të tjerët aq e tmerrshme ishte grabitja mes vetes.

Ngjytja e Kurorës përmes dimrit, përçapje dëshpëruese e papërfytyrueshme. Nuk ishte eje sa vrap, po zvarritje e mundimshme. Neridi çante dëborën, tërhiqte pas gruan, që rënkonte dhimbshëm e tmerruar. Ndjekësit lëviznin në gjurmët e tyre.

Mosha e re dhe ndjenja e perëndishme triumfuan. Kundërshtarët u lodhën, largësia rritej me shpejtësi. Gurani e kuptoi i pari të pamundurën, atë që nuk arrihej dot me asnjë çmim, asnjë sakrificë. Nepërkës po i firoheshin me shpejtësi fuqitë, ndaj më shumë zvarritej mbështetur pas krahut të tij.

Kaloi mesi i natës, në një ndjekje të pashpresë, torturuese, të pamundur.

- Nuk arrihen, - tha Gurani - atë që s'mundemi ne do ta bëjë Kurora.

U ulën. Prijësi me fuqi të prera gulçonte i dëshpëruar. Sytë qenë drejtuar qafës së malit nga u zhduk gruoja flokëzeze, thelbi i kuptimit të jetës së tij të mbetur. Do të kthehet, nuk mund të më braktisë, përimitonte shpresëprerë.

Ajo e di, nuk mund të vë dorë mbi të veçe për ta përkëdhelur. Fytyra e ngrysur pasqyrore pikëllim torturues, teksa shikimi mjegullohej dhe jeta po largohej gjithnjë e më shumë.

Burri më i fortë i fisit firohej e mpakej me ritme marramendëse. Zvarraniku përngjitur mbi faqe kishte humbur egërsinë. Frymëmarrja po sosej me shpejtësi. Goditje fatale, vrastare.

Sytë ngrinë me vështrim nga maja e Kurorës.

Gurani nuk foli një copë here. Vështronte i tronditur si shuhej pa kthim, me shpejtësi të lemerishme një jetë burri. Pastaj hodhi mbi supe kufomën, i nemitur, i pagojë.

Ndjekja u bë legjendë.

Askush nuk e dinte, as merrte me mend fatin e të dashuruarve. Të vjetërit besonin se Kurora i kishte futur në gjirin e saj, varrosi bashkë me kufomat ndjenjën e çmendur. Shpirtat e tyre endeshin të tromaksur përmbi Kurorën e Valamarës, trazonin ëndrrat e guñehiritëve.

Vetëm Gurani nuk besonte. S'mund të vdisnin dy burra për të njëjtën grua. Neridi e mundi Nepërkën në një dyluftim zemrash, si nuk pati ndodhur kurrë më parë. Nuk ishte dëshje thikash, nuk që mejdani i prijësit, ku fitonte gjithkrahë. Djali triumfoi bindshëm, katërcpërisht, pse duhej të vdiste?

Në fund të majit, me largimin e dëborës u zbulua e fshehta përvëluese. Përmbi Senisht, në mes të lëndinës më të hijshme të vendit, u shfaqën si prej nëndhesh dy gurë me pamje tronditëse njerëzish, që duan të përqafohen, po nuk mundën asnjëherë. Nuk kishin qenë kurrë më parë.

Pamje me mungesë të llahtarshme. Njeri kishite flokë të rëndë prej guri ngjyrë gri. Zgjatimi i një pjesë të gurit tjetër përcjell dhunshëm imazhin kapitës të dorës që kërkon të zhytet në flokunajën e dendur, po nuk mbërrin kurrë. Një hije kërcënuese, vëmendjethithëse dhe gjithëkohore e mërgon, e mban pezull në përjetësi të gurshme.

# Drejtori që vlerësonte punën e jo biografisë

Nga Pëllumb ZADE

Të shkruash për Rexhep Topin është një kënaqësi, pasi jeta e tij tepër aktive ta jep këtë mundësi. Ai ka lindur në simotrën binjake të Mokrës, krahinën e Gorës, duke përvetësuar të gjitha tiparet e mrekullshme që gëzojnë banorët e kësaj zone.

Personalisht, e kam njohur nga vitet '57-'58 kohë kur i kthyer nga studimet për specializim jashtë shtetit, ishte drejtor i shkencave të Straugert. Unë isha tepër i ri, e më tepër se sa puna, më tërhiqte humori e sidomos kënga e tij popullore. Kur këndonte Rexhepi me Zalo Nuken "Kur mërzen çjapi me zile" radiot (mbasi në ato vite nuk kishte televizor) hapeshin deri në fund, për ta shijuar sa më të plotë zërin melodioz të dy këngëtarëve. Por njohja ime me Rexhepin, ka qenë më e plotë në vitet '68 kur ishte drejtor i N.F.P (Ndërmarrja e furnizimit të punëtorëve) në Përrenjas, një ndërmarrje që ato vite shquhej për punë e shërbim komod ndaj punëtorëve, por edhe për realizimin e planit të shtetit.

Ishte koha kur unë i porsa liruar nga ushtria endesha lart e poshtë për të gjetur punë sipas profesionit, por e kisha të pamundur mbasi ngado më ndiqte hija e zezë e biografisë politike. Në këto kush-

te, u paraqita te drejtor Rexhepi në qytetën e Përrenjasit. Ai më njihnte si kuzhinier të mirë, por nuk dinte gjë për biografinë time. Ndërsa unë mora guximin e ia tregova të gjitha "mëkatet" politike të familjes Zade u step pak, por vendosi të më marrë në punë. Nuk qe e vështirë të kuptoja se kisha të bëja me një drejtues që suksesin e karrierën së tij nuk e zbatonte në luftën famëkeqe të klasave si shumë të tjerë, por në ndershmërinë dhe aftësitë e veta. Gjatë pesë vjetësh punë që kalova në këtë ndërmarrje u njoha më shumë me Rexhepin. Ai ishte i papërtuar në punë, i kudondodhur e sidomos shumë modest. Asnjëherë nuk e quante veten superior ndaj vartësve të tij, e deri tek punëtorët e thjeshtë edhe se ishte drejtor i ndërmarrjes dhe gëzonte funksione të tjera partiake. Për këto cilësi gëzonte dashurinë dhe respektin e punonjësve e si rezultat punët shkonin shumë mirë. N.F.P e Përrenjasit është ndër të parat jo vetëm në rrethin e vet por edhe më gjerë. Cilësia e gatimit, shërbimi ndaj punëtorëve, rregulli e pastërtia në fjetore, ishin bërë shembull edhe në shkallë republike. U bënë disa konsulta si në Përrenjas e në sektorin e minierës së Bushtricës ku specialistë e drejtorë nga rrethet e tjera, morën pjesë për shkëmbim eksperience.

Në këto kushte, Z.Rexhep u emërua



Rexhep Topi

drejtor i minierës Pishkash, një ndërmarrje me shumë peshë për kohën. Edhe këtu sukseset vinin hap pas hapi, por ajo që dua të theksoj është thjeshtësia me të cilën drejtohej nga Rexhep Topi.

Në minierë punon shumë punëtorë nga Mokra, zona përreth, nga Rrajca etj.,

e për Rexhepin të gjithë ishin të barabartë, dallimi bëhej vetëm nga puna e tyre, ku secili merrte atë që i takonte.

Nën drejtimin e tij miniera modernizohej hap pas hapi duke ulur në minimum përqindjen e aksidenteve në punë, plani realizohej e tejkalohet cdo muaj. Natyrisht, çelësi i këtyre rezultateve ishte mënyra e drejtimit dhe komunikimit të Rexhepit me punonjësit e tij duke fituar simpatinë dhe respektin e tyre të plotë.

I ndarë prej 35 vjetësh, mendova se do e kem të vështirë për ta njoftuar por që në fakt e dallova menjëherë, sapo e takova në Përrenjas, e u gëzova mbasi fizikisht mbahej shumë mirë. Entuziast si dikur, më zuri për dore e na futi në shtëpi për të na qerasur sipas zakonit. Nuk qe e vështirë të kuptoja se kisha të bëja me një familje model e në harmoni të plotë e sidomos mbesa e vogël shumë inteligjente, që në çdo çast ngjitej pas gjyshit të vet të dashur.

Djalë e vogël Turin, për meritat e tij personale, por natyrisht dhe ato të familjes populli i qytetit Përrenjas e ka zgjedhur Kryetar i Bashkisë duke treguar se besimi në punën e ndershmërinë e tyre jo vetëm nuk është lëkundur, por është rritur së tepërmi.

Me këtë shkrim të shkurtër, le t'i urojmë Rexhepit një shëndet të plotë, e Turit një sukses në karrierën e tij.

Bisedë me shkrimtarin Ardian-Christian Kçyçku - Pogradec-Bukuresht, gusht 2009

## Një zë nga Pogradeci i përherëshëm

- Cilët janë poetët që ju parapëlqeni: Homeri, Dantja, Gëteja, Botevi, apo Mihai Eminesku?

Ardian-Christian Kçyçku: Meqë thatë poet, po them Mihai Eminesku.

- Ç'është për ju familja?

Ardian-Christian Kçyçku: Ushtarëve të hershëm u theksohej se, në luftë, disiplina është shpesh më e rëndësishme se vetë jeta. Në këtë jetë që është luftë e shumëfishit, ose anasjelltas, familja mbetet gati po aq e rëndësishme sa jeta.

- Në Bulevardin Europa, në aksin qëndor, janë vendosur pllaka mermeri me emrat e figurave të shquara të kontinentit... Me shkrimtarëve Hygo, Servantes, Dostojevski, Kafka, Ibsen etj, cilin keni më për zemër?

Ardian-Christian Kçyçku: Bulevardi që zutë në gojë m'u duk një brinjë e sëmurë, ngulur si për zbatim të ndonjë direktive, mes brinjëve të natyrshme të qytetit. Kishte hije mortnore dhe nuk e shmangie dot përshtypjen se po shkel mbi eshtrat e ca njerëzve, shumica dërmuese e të cilëve rrojtën e vdiqën pa marrë vesh fare ç'ishte e nga binte Pogradeci. Më saktë: nga binte Enkelana, që ishte qytezë kur Evropa e sotme kishte më pak emërtime se fise, e shumë më tepër fise se sa qyteza. Por ndoshta do të vijë koha kur në një rrugë të hershme të Pogradecit, vendës e ardhacakë të shohin një riprodhim të shtëpisë së Lasgushit, ose qoftë edhe ndonjë tullë, a gur temeli, një riprodhim të shtëpisë së Mitrushit, të Kinema "Pojskës", të Turizmit të Vjetër, të Muzeumit, ndonjë nga gjemitë e dikurshme të peshkimit, një avlëmend ("vegël" në gjuhën e plakave tona), një akuarium të madh me koranë, belushka, mërena, pllashica, karavidhe etj, disa rrjeta si qëmoti, brendinë e ndonjërit prej shumë qilareve ku bëhej vera e rakia, disa bute, ndonjë kazan rakië, ndonjë hardhi, si dhe një mur të mbushur me fotografi nga Pogradeci i përherëshëm, por edhe me

vende të veçanta, ku njerëzit të shkruajnë përshtypjet e tyre, ose të vendosin fotografi, fletë dorëshkrimesh, etj... Gjendet një kafene e hijshme në Pogradec, Shtëpia e Miqve quhet, ku mbahen gjallë me përkushtim copëza nga epokat magjike të qytetit.

- Jetoni prej kohësh në Rumani. Cilat janë, sipas jush, lidhjet më të forta midis Shqipërisë dhe Rumanisë?

Ardian-Christian Kçyçku: Edhe sikur të pëmindim vetëm se hapësira rumune, ose mioritike, siç quhet shpesh, mbetet hëpërhë më fatlumja për letrat shqipe, veçanërisht për shkrimtarët e mëdhenj të lindur në Pogradec, si një truallgjuhë ku panë së pari dritën disa nga kryeveprat e letërsisë shqiptare, do të mjaftonte.

- Ndër figurat e shquara të politikës, në bulevardin që zutë në gojë pak më parë, janë... Cilët preferoni?

Ardian-Christian Kçyçku: Po ju përgjigjem me një pyetje mëse të merituar nga politika: cili prej tyre bëri që unë të kem një shtëpi timen në Pogradec nja 740 vjet pasi fisi im jeton këtu?

- Mes filozofëve që radhiten aty për-menden Platoni, Volteri, Zhan-Zhak Rusoi, Niçja etj. Cilin preferoni?

Ardian-Christian Kçyçku: Nuk e pashë gjëkund emrin e Shën Maksim Dëshmuesit, për shembull, as të Monsin-jorit Vladimër Gjika, para veprës filozofike të të cilëve mjaft mendimtarë zulumëdhenj jo vetëm duken, por edhe janë ende në gjendje veze.

- Ndër skulptorët e shquar janë Mike-lanxhelo, Rodeni e të tjerë...

Ardian-Christian Kçyçku: Keni dëgjuar ndonjëherë për rumunin Konstantin Brankush, që jetoi në Paris, i njohur si Princi Fshatar, dhe i cili thoshte se skulpturat e tij janë gjer edhe për të verbërit? Nuk ka dalë deri më sot ndonjë i

verbër ta kundërshtojë. As ndonjëri me sytë në ballë.

- Dramaturgu që ju admironi?

Ardian-Christian Kçyçku: Më ka befasuar Luixhi Pirandelo.

- Pija që ju pëlqeni?


Ardian-Christian Kçyçku: Vera "Gjims", gjysmëlitrëshe, e Pogradecit, dhe fërneta.

- Ngjyra juaj e preferuar është jeshilja, e kuaja, apo e kaltra?

Ardian-Christian Kçyçku: E muzgut.

- Përshtypja juaj për Pogradecin e sotëm.

Ardian-Christian Kçyçku: Ndonëse nuk jetoj këtu prej vitesh, nuk vij asnjëherë si turist dhe asnjëherë rastësisht. Koha e të qenit larg i ka fshirë tashmë mjaft nga kujtimet e pakëndshme dhe të gjitha zhurmat e gërvimat që nuk i vlejnjë letërsisë. Ndodhi që kësaj here, kur erdha të festoj dyzetvjetorin, Enkelana e fëminisë sime, e librave në shqip e rumanisht, dhe copëza thelbësore të Pogradecit të sotëm të gërshetoheshin mrekullisht. Varrezat e qytetit, Gështhenjat, qenë ngushtuar, a thua se të gjallët, në ngarendjen e tyre për të rrënuar, ndër-tuar, rrënuar etj, mezi presin t'ua marrin frymën të vdekurve, me bindjen se atje rri groposur vetë Kujtesa, ose të dëshmojnë se ky qytet ka vetëm të gjallë. Ca shënja të kësaj natyre, siç ishte shkarja e varreve dhe përzjerja e eshtrave, nuk duhen shpërfillur. Pogradeci ka pasur aftësinë t'i përshfaqë njerëzisë nga një fytyrë për çdo kohë, duke pasur vend për të gjithë, por kuptohet: shumë janë të ftuar, pak janë të zgjedhur. Se vend kishte edhe Kina perandorake kur u dynd nga të pafuarit që kishin më shumë armë në duar, se sa fjalë në gjuhë, dhe perandori urdhëroi të mos luftonte kush, por vetëm të hapeshin dyert – dhe hynë të pafuarit qosh më qosh, rrëmbyen toka e varre e



shpikën prejardhje e më-the-të-thashë, dhe pas disa muajsh e gjithë popullsia ishte sërish krejt kineze, asnjë të pafuari nuk i gjendej gjurma, varri, kujtimi, prejardhja. Jo rastësisht në Pogradec vinte Lasgushi, vinte Mitrushu, por vinte edhe E. Hoxha, vinin korifejtë e realizmit socialist, si dhe gjithfarë drejtuesish partie, ish-luftëtarë, ish-të përndjekur, çifte të rinj për muajin e mjalitit, apo thjesht me pushime. Të gjithë dukeshin të përjetshëm e të pazëvendësueshëm, por, në të vërtetë, si i këqyrte dhe si i trajtoi kujtesa e Pogradecit? Sa më përket, gjithnjë prania ime këtu është dukur gjysmë fantomatike. Mbase ngaqë qysh kur nisa të shkruaj, pò në Pogradec, jam gjendur vazhdimisht mes të vdekurve e të gjallëve, mes Pogradecit të mirëfilltë, një Pogradeci kalimtar, vetes dhe Pogradecit që ngjizej në librat e mi. Në mbi dhjetë syresh (po përmend vetëm zv.Libri, Sy, Viti kur u shpik mjellma, Diva ose Ngrënësi i Luleve, Mortët, Një fis i lavdishëm e që jep shpirt, Puthmë skelet – roman me femëni, Demi i Zi) mund të lexohet tashmë Pogradeci si një glob në miniaturë, ose universi si një Pogradec i zgjeruar. Jashtë librave, u çmalla me të afërm e miq që nuk i pata parë ç'prej afro njëzet vjetësh, dhe takova njerëz e shkrimtarë që më njihnin vetëm nga librat dhe nga ato që shkruhen rreth punës sime. Një përshtypje të këndshme gjeti ime bijë, e cila vinte për herë të parë në Shqipëri. Ngaqë shkruan e vizaton parreshtur, ajo ka heraherës mpirje kyçesh. Falë kaq duarve sa shtrëngam këto ditë, më tha e ngazëllyer, të paktën për ca vjet do të shkruaj pa frikë.

## JETON MUÇOLLARI E JETON JETËN ME DINJITET, ME KRIJIMTARI ARTISTIKE

Nga Zenun FERRO

### HISTORIA E AKSIDENTIT

Në emisionin me "Zëmër të hapur" në televizionin NEWS-24, të drejtuar nga zonja Evis Ahmeti, u njoha me jetën e Jeton Muçollari, nga Pogradeci.

Jetoni aksidentohet në punë në minierë nga goditja e një vagoni më datën 11 janar 1991. Pas kësaj për këtë filloi një jetë e vështirë, por ai e përballoi dhe po e përballon duke pasur në krah bashkëshorten shokun e jetës, Vjollcën. Kishin dy vjet martesë kur ndodhi kjo tragjedi. Lindja e vajzës Matilda, e gëzoi familjen, e forcoi atë më tepër. Lindi një yll për ta.

Vjollca është një grua e veçantë Pogradecare, ajo i qëndroi gjashtë muaj të shoqit në spital. Çfarë nuk i thanë por ajo i shërbeu, e mbajti amanetin. Jeta eci dhe ja ku janë tani. Matilda e mori vesh nga nëna, se babai ishte i sëmurë, por pati një mbështetje nga babai i saj. Nga Pogradeci, sipër në karrocë, Jetoni e kërkon jetën të gjallë. Nis një ditë një letër emisionit televiziv "Me zëmër të hapur për jetën e tij. E filloi krijimtarinë që në klasën e tetë, por tregimin nuk ishte optimist, nuk pa rrugën e botimit. Pas aksidentit shkroi por pa menduar se do t'i botohte. Por ja që i botoi në një libër "Shpirti i brengosur, poezi" Në këtë libër ka gjëra të tjera për të tjerët. Shkrimtari Bardhyl Xhama, pjesëmarrës foli fjalët më të mira, Jetoni, si ka emrin ashtu është e jeton jetën me realitet. Ka një familje të mrekullueshme, një familje për të marrë shembull në realitetin shqiptar.

### TELEFONAT JAPIN PËRSHËNDETJE.

Nga Italia, flet një dëgjuese, falenderoi Vjollcën, për shërbimin që i bën bashkëshortit. Ky ka qënë fati, ti je si Myzejen Duka nga Durrësi, që shërben Osman Dukës për shumë vite.

Miku i Jetonit nga Kukësi flet në telefon, ai vërtet rri në karrike por ka një ton magjik. Është miku i mirë, njeri i mirë. E priti pas emisionit në takim. Urime i erdhëm Jetonit nga një dëgjues nga Tirana, e urime të veçanta Vjollcës, vajzës, ky njeri të bëhet objekt në të gjithë Shqipërinë, për aktin heroik.

(vijon nga faqja 5)

Do të shtoja se një ditë para përfundimit të ekspeditës (29 korrik 1975), sipas udhëzimeve nga drejtorja e Institutit tonë dhe si kudo nëpër rrethet e Shqipërisë, pata një takim pune në seksionin e arsimit dhe të kulturës të rrethit të Pogradecit. Qëllimi kryesor ishte problematika rreth ngritjes dhe veprimtarisë të bërthamës folklorike të rrethit të Pogradecit.

8) Siç u tha, në ekspeditën e Mokrës më 1972, për arsye teknike filmimet e valleve nuk u realizuan. Por lënda e mbledhur është e sitemuar në AIKP e regjistruar muzikalisht nga Hysen Filja. Po shënojmë disa nga njësitë koreografike, sipas titujve, fshatit dhe numrit të fonotekës: "Vallet e burrave të Mokrës së Poshtme", (bashkëbisedim nga R. Bogdani dhe N. Agolli me Mersin Alla, fshati Vërrë, fonot. 874/2); "Atje posht' te çezm' e madhe" (grup burrash nga Vërrë; fonot. 873/13); "Më rrëmbeu gegë çobani" (grup grash nga Vërrë, fonot. 873/14); "Ku këndonin zogat-o" (grup grash nga Vërrë; fonot. 874/1); "Vallja e trimave" (grup vajzash nga fshati Slatinë, fonot. 373/3); "O çoban të qan çobanka" (grup grash nga fshati Rodokal i Sipërm; fonot. 871/2); "Kur rrudhesh bilbil prej mali" (grup grash nga Rodokal i Sipërm; fonot. 871/8); "O i pari i valles -o" (grup grash nga Rodokal i Sipërm; fonot. 871/9); "Luan një vashë belhollë" (grup grash nga Kriçkova, fonot. 872/2); "Djali vogël axhami" (grup burrash nga Rodokal i Sipërm; fonot. 873/7); "Ditën e Pashkës së Madhe Dho-

Dëgjuesja nga Londra, e pyet që shkrimet kujt ja ka bërë, temën nga e kini marrë? Jetoni përgjigjet; nga të gjitha ngjarjet në jetë, nga fantazia ime krijuese. Dëgjuesi përgjigjet: Një libër mbi 1000 fletë ti bësh Vjollcës e vajzës, ato të dyja kanë bërë një sakrificë të madhe. Edhe babai im u aksidentua si Jetoni por mamaja ime u largua nga babai, ai jeton me mua. Po i lënë burrat gratë dhe gratë burrat pa asnjë shkak, na ka hapur plagën ky emision, por për emisione të tilla ka nevojë njeriu dhe shoqëria jonë, sepse po shkatërrohen familjet dhe fëmijët.

Mësuesja në pension, në Tiranë telefonon se këto emisione i kam ndjekur, nga pasioni, mosha, kultura. Këto janë gjëra të rralla, nuk të shërben njeriu kaq me besnikëri. Kjo tregon traditën shqiptare që kanë pasur gratë, të cilat i prisnin burrat nga Amerika. Edhe kur merrnin lajmin e keq, ato vazhdonin jetën e mbanin shpëtimin, nderin. Unë librin e Jetonit, do ta blej, do ta lexoj se ky e meriton.

Zonja Muzejen nga Shijaku, flet, nga Shijaku, kërkoj të kalojë disa orë me familjen e Jetonit. Dua ta takoj, nga ai ka marrë shumë forca. Jeta të godet në çdo moment, por duhet jetuar. Ai më ka ndihmuar nga ana psikologjike.

Hysni Pasha nga Korça flet, se jeton ai që ecën vetë. Ai që ecën dhe nuk vdes. Jeta përballohet me punë, me gjëra të mira.

Punonjësja në Qarkun e Vlorës, flet, është ngjarje e madhe që duhet të vlerësojmë, ta mbështesim administrata shtetërore, ligjet e shtetit të jenë më të favorshme për këta persona. Kjo është një nevojë që ka njeriu për jetën, jo më tepër.

Është rasti i jashtëzakonshëm, ne shkrimtarët jemi shumë të ndjeshëm. Kjo familje ka 20 vjet që jeton, jetën nuk e braktis atë.

Psikologja Arjana Kaza, thekson se kjo është një ngjarje që forcon familjen që sot ajo ka pasur tronditje të madhe. Aksidenti mund të sillte një ndarje totale, të kësaj familje, por ajo u bë shembull Jetoni, Vjollca, Matilda kane gjetur rrugën e traditës shqiptare. Duhet të përballohen ditët e vështira, familja është bërthama me vlera të mëdha. Nga stafi i gazetës "Mokra, Jetonit i urojmë, krijimtari artistike dhe i premtojmë se këto shkrime do t'i botojmë.

qina na hidhte valle" (grup grash nga Pleshishti, fonot. 874/13); "Lot një vashë atje nga fundi" (grup grash nga Trebinja, fonot. 873/6); "Nusja me duvak" - argëtim koreopantomimik, (bashkëbisedim nga N. Agolli dhe R. Bogdani me Dilaver Bega nga Slabinja, fonot. 874/3); "Vallet e grave të fshatit Pevelan", bashkëbisedim nga R. Bogdani dhe N. Agolli me një grup grash nga Pevelan, Fonot. 874/5); "Vallja e Ymer Agës dhe e Dhoqinës", (bashkëbisedim nga N. Agolli dhe R. Bogdani me një grup grash nga Pleshishti, fonot. 874/5) etj.

Më gjerë, siç u tha, ekspedita e Mokrës 1972 është përfshirë në Fletorja nr. 20, Ekspedita e parë në fshatrat e Mokrës së Pogradecit (shtator-tetor 1972), AVA, 102 faqe.

Për këtë ekspeditë shih edhe N. Agolli e R. Bogdani "Vallet në krahinën e Mokrës", "Drita", Tiranë, 1973, 21 janar, f.11.

9) Pas zhvillimit të këtij tubimi në një nga organet e shtypit u shkruajt: Më 1 gusht 1987, në shtëpinë e kulturës dhe krijimtarisë popullore të qytetit të Pogradecit u zhvillua biseda "Vallet e Mokrës dhe të krahinave të tjera të Pogradecit në rrafshin e vallëzimit popullor shqiptar", nga Ramadan Bogdani. Valltarët, këngëtarët, rapsodët, studiuesit e folklorit dhe të ftuar të tjerë nga qyteti dhe shtëpitë e vatrës e kulturës së rrethit ndoqën me interes bisedën. Ajo ishte ilustruar me filmat e valleve përkatëse, të realizuara vite më parë nga autori, përmes ekspeditash kërkimore të Institutit të Kulturës Popullore në zonën e Mokrës dhe gjete.

## EMRI GANI LINI - TIRANA U FITUA ME PUNË, DASHURI E BUJARI

Nga Nezir SULOLLARI

Gani Sulollari lindi në fshatin Lin të rrethit Pogradec në vitin 1907, u rrit dhe u edukua në këtë zonë me tradita patriotike e atdhetare. Familja jetonte në Plevic, kodër në zbritje të rrugës së Qafë-Thanës, para se të hysh në fshatin Lin.

Për jetë më të mirë Ganiu në vitin 1928 shkon të punojë në Tiranë. Me një vajzë nga fshati Homezh, Alije Bizgjoni, krijoi familjen duke punuar dhe forcuar atë. Punoi për një kohë të gjatë si puntor në centralin elektrik të Tiranës.


Me kursimet e bëra bleu tokë në fshatin Lin dhe ndërtoi një shtëpi dy katëshe. Ai gjithmonë ndihmonte familjen dhe prindërit në fshatin Lin, me të gjitha mallrat ushqimore dhe i dërgonte me autobuzin e linjës Tiranë-Korçë, që shkonte dy herë në muaj. Ai kishte një mall për vendlidjen dhe shkonte shpesh atje, pyeste njerëzit që vinin në Tiranë. Duk qënë punëtor i centralit elektrik, në vitin 1951 caktohet të punojë në termocentralin e Kombinatit Tekstil si motorist, elektrikist. Atje ai punoi me pasion të madh deri sa doli në pension në vitin 1967.

Në Mokër, Ganiu e njihnin si një burrë të mirë, bujar dhe mikpritës, që nga fshati Lin, Piskupati dhe shumë fshatra të Mokrës, Laktesh, Radokal, Katjel, Homezh, Përrenjas, Urakë, Rrajcë e tjerë. Për vizita mjekësore në Tiranë tek doktorët Basha, Zyma, Tartari, Kristidhi, Harito, ka ndihmuar shumë pogradecarë. Ai i ka pritur, vizituar dhe i ka përcjellë me dashuri.

Në Mokër Ganiu ka qënë nip tek Derwish Nofulla nga Rodokali, një burrë i këngës bujare dhe i pushkës partizane. Ai



Centrali elektrik, Tirane



## PELIONI - QYTET

Nga Hysen KOÇILLARI

Dasaretët ishin një fis i madh në Shqipërinë juglindore. Njiheshin në lashedisi sidomos per prodhimin e drithërave të bukës. Një nga qytetet më të përmendura ishte Pelioni (qyteza në Selcën e Poshtme të Pogradecit). Qytet tjetër i madh i këtij fisi ishte Antipatra (Berati), (H. Myzyri "Historia e popullit shqiptar" Tiranë 1994, faqe 6-7). "Demosteni (384-322, para krishtit orator dhe politikan i njohur i Athinës) shekulli IV para krishtit, përkundrazi përdor termin poleis që do të thotë qytet (në vend të termit polis-ma, që do të thotë qytet të vogla, të përdorur nga Diodori (jetoi në Sicili në kohën e Çezarit e Agustinit), "Autor "Biblioteka Historike". Pak dritë mbi këtë



ka pasur mik Selman Çoçon e Salo Malometa në Katjel, Sabri Bizgjonin në Homezh, Kdri Gjonën në Laktesh e shumë e shumë të tjerë.

Gjatë Luftës Anti fashiste NÇL, Ganiu ka ndihmuar Reshit Çollakun kur ndodhej në Tiranë në nëntor të vitit 1941. Detyra i'u caktua që ai të mos largohej nga centrali elektrik.

Ganiu rriti katër fëmijë, tre djem Nezirin, Petritin e Gëzimin dhe një vajzë, Selvien, shumë të edukuar e punëtorë që kanë krijuar familje të mrekullueshme.

Në Mokër Ganiu shkonte me roba të zonës, me një frak të zi dhe me një qylaf të bardhë. Të gjithë e prisnin mirë, se edhe ai bënte shumë për ta, kur vinin në Tiranë. Ai kërkonte që edhe fëmijët e tij të respektonin vendin ku kishin lindur.

Në muajin shtator të vitit 1977, u nda nga jeta, në moshën 70 vjeçare. Në ditën e përcjelljes për në banesën e fundit zona e Mokrës e nderoi me pjesëmarrjen e saj. Ganiu ka ngelur në kujtesën e familjes dhe të miqëve të tij, burri që fliste pak dhe punonte shumë. Të gjithë të afërmit e tij e kanë ndier mungesën e Ganiut, ish-te Sulollari, por me ardhjen në Tiranë, nuk i thoshin më Gani Sulollari por të gjithë e njihnin Gani Lini, Tirana. Pra Gani Lini ka ngelur i paharruar në histori dhe si një burrë me vlera në rrethin e Pogradecit, në Lin, Mokër e Tiranë.

çështjeje (kohës së lindjes së qyteteve në shekullin e IV-të para krishtit -Shënimim), hedh pohimi i Arianit, i cili e quan Pelionin si qytetin "qytetin më të fortë" midis Desaretisë. Pelioni shfaqet në burimet jo vetëm si qytet më i fortë midis qyteteve të Desaretisë, por edhe si kryeqëndërq, apo qëndër rezidenciale e mbretit ilir". ("A.SH.SH, "Histori e popullit shqiptar" Vëllimi I, Tiranë 2002 faqe 63)

Pelioni shënon pikat kulmore të origjinës të këtij komuniteti. Ky emër zë vend të pa diskutueshëm e të rëndësishëm në zhvillimet historike mbarëkombëtare shqiptare. Ky emër e bën historinë trevës etnike të Mokrës, të pranueshme prej të gjithë niveleve shkencore, si pararendëse të banorëve të sotëm.